



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
KATEDRA E GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

PUNIM I MAGJISTRATURËS

Teza:

BOTA POETIKE E ALI PODRIMJES

MENTORI:

PROF. DR. ZEQR KADRIU

KANDIDATJA:

ZIMRAJE NEVZADI

TETOVË, KORRIK 2020

Falënderim

- Falënderoj
 - **Prindërit**, që më sollën në dritë dhe më porositnin të mos pendohem në jetë.
 - **Vëllanë**, për përkrahjen dhe bashkëvuajtjen me mua.
 - **Bashkëshortin tim**, për mirëkuptimin dhe ndihmesën në udhëtimin së bashku, në të mirë dhe në të keqe, për arritjen intelektuale dhe kujdesin ndaj nesh.
 - **Familjen e gjerë dhe farefisin**, që vazhdojnë të më nderojnë.
- Falënderim e përkulje
 - **Mësuesve tanë**, të gjallë e në tejbotë.
 - **Librave**, që më dhanë e më japin pakrahasimisht më shumë se sa duhet.
- Falënderim dhe mirënjohje të veçantë
 - **Profesorit – mentorit Zeqir Kadriu**, për mirëkuptimin, durimin dhe këshillat e vyera profesionale e njerëzore.
 - **Profesorëve të tjerë të nderuar**, për qasjen dhe punën dinjitoze.
 - **Falënderim e respekt edhe kolegëve të mi** që më kanë respektuar dhe më kanë konsideruar si familjaren e tyre.

Përmbajtja

Falënderim	2
Hyrje.....	4
Qëllimi i hulumtimit	6
Metodologjia e studimit	7
Kreu I	9
1. Jeta dhe veprimtaria e poetit Ali Podrimja.....	9
1.1. Veprat poetike të Ali Podrimjes	14
1.2. Veprat poetike të Ali Podrimjes të botuara në gjuhë të huaja	15
1.3. Panorama dhe antologji në gjuhë të tjera	17
1.4. Ali Podrimja në panorama e antologji shqiptare e në gjuhë të huaja.....	17
1.5. Çmimet vlerësuese për krijimtarinë e Ali Podrimjes	19
Kreu II.....	21
2. Ali Podrimja zë i veçantë në letërsinë shqiptare	21
2.1. Arti poetik i Ali Podrimjes	24
2.2. Realiteti jetësor në poezinë e Ali Podrimjes.....	29
Kreu III	32
3. Temat dhe motivet e Ali Podrimjes	32
3.1. Tematika e Podrimjes.....	35
3.2. Mitet kulturore që e drejtojnë poetin.....	38
Kreu IV.....	42
4. Ali Podrimja dhe revolta në vargun poetik për Kosovën	42
4.1. E bukura si kërkim e mbijetesë.....	46
4.2. Podrimja dhe emblema hamletiane	50
Kreu V	53
5. Të tjerët për Ali Podrimjen – kritika	53
Përfundim.....	62
Literatura	66

Hyrje

Ky punim që ka si objekt studimi poetin kosovar Ali Podrimja është mbështetur në evidentimin, përshkrimin e vlerave letrare dhe gjuhësore të krijimtarisë poetike të tij, si dhe vendin e tij në poezinë shqipe. Përgjatë analizës së lëndës poetike i është mëshuar së shumti aspektit të shprehjes dhe formave të artikulimit gjuhësor si rrugë e pasurimit të shqipes. Nga studimet e shumta bërë veprave të poetit tonë të mirënjohur Ali Podrimjes, kam parë që vepra e tij është e pasur dhe e larmishme. Ali Podrimja me poezinë e tij solli një frymë të re në letërsinë shqipe. Duke qenë poet bashkëkohor, një pjesë e mirë e poezive të tij kanë për tematikë Kosovën. Veprat e Ali Podrimjes janë dhe do të mbesin një motivim për të gjithë shqiptarët që ta duan atdheun dhe t'i jenë pranë çdoherë kur ka nevojë për ta. Me anë të veprave të tij, Ali Podrimja kishte për qëllim që të zgjojë ndjenjën kombëtare. Pikërisht tematika atdhetare për Kosovën si dhe ajo e dashurisë kanë qenë motivim i hartimit të këtij punimi shkencor, sepse veprat e tij ende arrijnë ta kenë atë funksion, ta ngjallë atë ndjenjë të atdhedashurisë.

Ali Podrimja konsiderohet mjeshtër i vargut poetik dhe sinkronizues i skajshëm sa i përket prekjes së tematikës për Kosovën. Podrimja u ikën normave konvencionale të vargut shqip. Preferenca e tij për ta lëvruar vargun e lirë e çon atë drejt kërkesave të tjera të vargut të cilat dalëngadalë vijnë edhe bëhen edhe kërkesa idesh për të kaluar përfundimisht në një varg sensibiliteti. Podrimja kryesisht i është kthyer lirikës me motive patriotike dhe politike për Kosovën, kur atëherë nisi të zhvillojë dhe ta paraqesë një zë të artikuluar ku shkruan vargje për shpirtin kombëtar, gjendjen politike të kombit të tij, qoftë kur shkruan vargje më personale.

Vepra e Ali Podrimjes shënon një moment të rëndësishëm të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë. Për shkak të kushteve historike dhe shoqërore në të cilat mori jetë vepra e tij, Podrimja krijoi një sistem të veçantë komunikimi duke arritur në një përsosmëri formale. Në kushtet e censurimit, vepra e tij shfaqet si kërkim i formës gjuhësore më të sigurt për të mbajtur të gjallë komunikimin me unin kolektiv. Po në këto kushte, ajo do të bëhet pjesë e jetës shpirtërore të shqiptarëve në Kosovë, por jo vetëm. Madje shumë vëllime poetike të tij janë konsideruar me tendenca hermetizmi.

Vepra e tij është dëshmi e plotë e zhvillimit të gjuhës shqipe në dy periudha të ndryshme të saj, para dhe pas kodifikimit të standardit. Në të njëjtën kohë, ai (me tendencë hermetizmi) është bartës i formave gjuhësore (leksikore, semantike, morfologjike dhe sintaksore) më “të çuditshme”. Krijimtaria e Podrimjes ka qenë objekt i studimeve të ndryshme në aspektin letrar në një qasje të analizës së vlerës letrare që mbartin si unikalitete të veçanta.

Dihet se kuptimi i poezisë është kontekstual, për shkak se “fjala bart me vete jo vetëm kuptimin që ka në fjalor si fjalë, por edhe areolën e sinonimeve dhe homonimeve. Fjalët jo vetëm kanë kuptimin, por edhe e grishin domethënien e fjalëve të tjera, të cilat janë të përafërta për nga tingëllimi, kuptimi, ose prejardhja - madje edhe të atyre që janë të kundërta, ose që përjashtohen”. Gjuha poetike ka një status të mëvetësishëm, që del jashtë funksionit të shenjës. Për të gjitha këto arsye, studimi i gjuhës bëhet shumë i rëndësishëm në procesin e analizës letrare, sepse në këtë mënyrë zbërthehet struktura e vargut nga pikëpamja grafike, sintaksore dhe kuptimore.

Në korpusin e shkrimtarëve, poetëve, që kanë dhënë kontributin e tyre në pasurimin e shqipes, shfaqet si zë i veçantë edhe poeti kosovar Ali Podrimja. Vepra letrare e Podrimjes përbën një nyje të veçantë në letërsinë shqipe. Poezia e tij është bartëse e risive të shumta tematike, formale dhe gjuhësore. Ajo, sidomos, në gjysmën e dytë të shek. XX, është shfaqje e përpjekjes për përsosjen e pasurimin e komunikimit letraro-artistik kushtëzuar nga rrethanat historike.

Vepra e Ali Podrimjes shënon një moment të rëndësishëm të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë. Për shkak të kushteve historike dhe shoqërore në të cilat mori jetë vepra e tij, Podrimja krijoi një sistem të veçantë komunikimi duke arritur në një përsosmëri formale. Në kushtet e censurimit, vepra e tij shfaqet si kërkim i formës gjuhësore më të sigurt për të mbajtur të gjallë komunikimin me unin kolektiv. Po në këto kushte, ajo do të bëhet pjesë e jetës shpirtërore të shqiptarëve në Kosovë, por jo vetëm.

Madje shumë vëllime poetike të tij janë konsideruar me tendenca hermetizmi. Vepra e tij është dëshmi e plotë e zhvillimit të gjuhës shqipe në dy periudha të ndryshme të saj, para dhe pas kodifikimit të standardit. Në të njëjtën kohë, ajo (me tendencë hermetizmi) është bartëse e formave gjuhësore (leksikore, semantike, morfologjike dhe

sintaksore) më “të çuditshme”. Krijimtaria e Podrimjes ka qenë objekt i studimeve të ndryshme në aspektin letrar në një qasje të analizës së vlerës letrare që mbart si unikalitet të veçanta. Ali Podrimja në poezinë e vet krijoi një poetikë personale, një regjistër të pasur shprehjesh figurative të papërsëritshme, shprehje me një dendësi kuptimi dhe emocioni të brendshëm dhe estetikë të përsosur. Krijoi një poetikë të artit të vet që diti të mbyllet përballë kontrollit ideologjik të kohës, por që diti të hapet përballë lexuesve të vet, sidomos përballë rinisë studentore të Kosovës, që në vitet shtatëdhjetë sidomos rritej e formohej, shtohej me të madhe, duke u mësuar të komunikojë me gjuhën ezopike të Ali Podrimjes.¹

Interesi ynë i studimit mbi krijimtarinë e Podrimjes, si pasuri kombëtare, konsiston në qasje të analizës së strukturave poetike të krijimtarisë që janë konsideruar me tendencë hermetike, por që në të vërtetë nuk arrijnë në cakun e hermetizmit. Duke vlerësuar dhe përvetësuar arritjet e studimeve në fushën e semantikës së figurshmërisë, po ashtu edhe të kritikës mbi veprën e Podrimjes, jemi përpjekur të evidentojmë proceset e përdorimit të fjalëve në mënyrë të figurshme drejt kuptimeve të figurshme në veprat e përzgjedhura për analizë.

Në korpusin e shkrimtarëve, poetëve, që kanë dhënë kontributin e tyre në pasurimin e shqipes, shfaqet si zë i veçantë edhe poeti kosovar Ali Podrimja. Vepra letrare e Podrimjes përbën një nyje të veçantë në letërsinë shqipe. Poezia e tij është bartëse e risive të shumta tematike, formale dhe gjuhësore. Ajo, sidomos, në gjysmën e dytë të shek. XX, është shfaqje e përpjekjes për përsosjen e pasurimin e komunikimit letraro-artistik kushtëzuar nga rrethanat historike.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i temës është si rezultat i kërkimeve shkencore që i është bërë veprave të poetit Ali Podrimja, është që të japë mendimin tim rreth tipologjisë dhe karakteristikave që mbizotërojnë në shkrimet e tij letrare, shfaqja e figurave letrare, fryma e sjellë dhe krijimi i një letërsie më ndryshe se të tjerat i bën edhe më tërheqëse studimet dhe hulumtimet rreth këtyre veprave të poetit në fjalë. Vepra e Ali Podrimjes shënon një moment të rëndësishëm të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë. Për shkak të kushteve historike dhe shoqërore në të cilat mori jetë

¹ Ali Aliu, Parathënie e veprës së parë të Ali Podrimjes, fq. 22.

vepra e tij, Podrimja krijoi një sistem të veçantë komunikimi duke arritur në një përsosmëri formale. Në kushtet e censurimit, vepra e tij shfaqet si kërkim i formës gjuhësore më të sigurt për të mbajtur të gjallë komunikimin me unin kolektiv. Po në këto kushte, ajo do të bëhet pjesë e jetës shpirtërore të shqiptarëve në Kosovë, por jo vetëm. Madje shumë vëllime poetike të tij janë konsideruar me tendencë hermetizmi.

Vepra e tij është dëshmi e plotë e zhvillimit të gjuhës shqipe në dy periudha të ndryshme të saj, para dhe pas kodifikimit të standardit. Në të njëjtën kohë, ai (me tendencë hermetizmi) është bartës i formave gjuhësore (leksikore, semantike, morfologjike dhe sintaksore) më “të çuditshme”. Krijimtaria e Podrimjes ka qenë objekt i studimeve të ndryshme në aspektin letrar në një qasje të analizës së vlerës letrare që mbartin si unikalitete të veçanta. Dihet se kuptimi i poezisë është kontekstual, për shkak se “fjala bart me vete jo vetëm kuptimin që ka në fjalor si fjalë, por edhe areolën e sinonimeve dhe homonimeve. Fjalët jo vetëm kanë kuptimin, por edhe e grishin domethënien e fjalëve të tjera, të cilat janë të përafërta për nga tingëllimi, kuptimi, ose prejardhja - madje edhe të atyre që janë të kundërta, ose që përjashtohen”.

Metodologjia e studimit

Objekti i punimit tonë është poezia e Podrimjes, vlerat e shumëfishta që ajo mbart, vendin e saj në hierarkinë e poezisë shqipe duke i mëshuar së shumti edhe aspektit të shprehjes, formave të artikulimit gjuhësor. Punimi ka synuar të sjellë një vështrim shumëplanësh të përmbledhjeve kryesore poetike të Podrimjes, duke e parë poezinë e tij edhe në sitën e kritikës. Veprat bashkëkohore kaluan një periudhë nëpër shtigje tepër të vështira duke u ngushtuar dhe kufizuar brenda një uniforme të metodës së realizmit socialist. Në vitet “50 respektivisht në vitet “60 filloi të lulëzojë kjo formë e të shkruarit në letërsinë tonë shqiptare. Për analizë të veprave të këtyre na kanë ardhur në ndihmë:

- metoda analizuese,
- metoda deskriptive,
- metoda hulumtuese dhe
- metoda empirike.

Nga ana tjetër, problemet e ligjërimit poetik janë parë në dritën e një analize të detajuar të poezisë së Podrimjes në raporte përqasëse. Lëvizjet kuptimore, në poezinë e Podrimjes, janë vështruar në strukturat minimale, ku ndodhin ndryshimet kuptimore, por nuk mundojnë rastet e analizës së strukturave më të mëdha në nivel të fjalisë apo edhe të thënies. Analiza në nivelin e fjalisë apo të thënies poetike është bërë për të parë lëvizjen kuptimore nga një njësi leksikore në tjetrën dhe plotësimin e strukturës kuptimore të ligjërimit letrar. Në përcaktimin e objektit të analizës kuptimore të poezive të Podrimjes jemi përpjekur të jemi më të kufizuar, pasi krijimtaria poetike e poetit është jashtëzakonisht e madhe dhe e larmishme. Për të realizuar një përshkrim dhe analizë më të qartë të pasurisë gjuhësore të këtij sistemi të veçantë komunikimi, kemi marrë në shqyrtim vëllimet poetike të Podrimjes si: “Torzo”, “Sampo”, “Folja”, “Credo”, “Dëftore” dhe “Lum Lumi”.

Kreu I

1. Jeta dhe veprimtaria e poetit Ali Podrimja

Pas copëtimit të trojeve shqiptare, letërsia shqiptare pati një shkëputje të vazhdimësisë natyrale të zhvillimit të saj. Pas vitit 1913, letërsia shqiptare pati disa qendra të zhvillimit të saj, trangu mëmë Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Dy epiqendrat e zhvillimit të letërsisë shqipe janë Shqipëria dhe Kosova, aty ku gjuha shqipe pasurohet dita – ditës, ku letërsia bëhet një forcë e madhe e transmetimit kulturor dhe mënyrë e forcimit të ndjenjës kombëtare. Shekulli XX e gjeti letërsinë shqipe në Kosovë në një etapë të rëndësishme të kristalizimit të saj. Forma poetike më dominante ishte poezia, kjo për dy arsye madhore: së pari ishte vazhdimësi e poezisë së epokës së Rilindjes; së dyti poezia ishte forma më e preferuar letrare ku e diktonin kushtet historike të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë. Ishte forma më e lehtë për t'u shkruar në kohë të shkurtër, më lehtë të qarkullohej në kohë kur shkrimet shqipe do të jenë të ndaluara dhe më e lehtë për t'u lexuar (si një tekst të shkurtër) nga lexuesi, që dinte shumë pak të lexonte në gjuhën mëmë.² Gjendja ka qenë e tmerrshme, sidomos për shkrimtarët dhe intelektualët shqiptarë të Kosovës. Ata përbëjnë kërcënimin më serioz për hegjemoninë serbe në rajon sipas udhëheqësit popullist Slobodan Millosheviq i cili, sikundër Rankoviqi para tij, nuk ka dëshmuar tjetër veçse mospërfillje ndaj kërkesave për barazi dhe të drejta njerëzore të popullatës shqiptare. Pa punë, pa burim të ardhurash, pa të drejtë për shkollim dhe pa shpresë për ndryshim tani për tani, gjendja e sotme duket tepër e zymtë në Fushën e Mëllenjave. Edhe pse pa tradita të pasura letrare si gjuha sllovene, kroate e serbe, letërsia shqiptare në zhvillim të vrullshëm në Kosovë tani mund të ecë pa vështirësi krah për krah letërsive të tjera ish-jugosllave. Letërsia e sotme e Kosovës është po aq dinamike sa edhe ajo e Shqipërisë, kurse për sa i përket larmisë dhe forcës shprehëse të poezisë së saj, shpesh ia kalon edhe tokës amë. Duke mos i pasur ato kufizime ideologjike që iu imponuan letërsisë dhe kulturës në Tiranë për një gjysmë shekulli, letërsia e Kosovës ka qenë në gjendje të lulëzojë krahasimisht e lirë nga dogmat. Prandaj edhe ka karakter më eksperimentues dhe i ofron lexuesit një gamë më të gjerë temash dhe idesh. Edhe pse niveli i përgatitjes së prozatorëve në Kosovë ende nuk ka arritur atë të Tiranës, fakti se praktikisht të gjithë

² Robert Elsie - Histori e Letërsisë Shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë & Pejë: Dukagjini 1997, fq. 302.

intelektualët e Kosovës e zotërojnë fare mirë serbokroatishten u ka dhënë mundësi jo vetëm të njohin letërsi të ndryshme artistike të popujve të tjerë të ish-Jugosllavisë, por edhe më shumë vepra të letërsisë botërore që nuk gjenden të përkthyer ende shqip.³ Poezia gjithmonë ka qenë në ballë të letërsisë në Kosovë dhe ka gëzuar më shumë popullaritet ndër shkrimtarë e lexues sesa proza. Kjo imagjinatë poetike ka rrënjë të thella në këtë tokë e në popullin e saj të mbujtur me aspiratat, mundimet dhe ëndrrat e veta. Kështu, poezia e Kosovës, si një organizëm i gjallë, kurrë nuk i ka humbur lidhjet me popullin. Deri në fillim të viteve tetëdhjetë në Kosovë ishin botuar rreth 70 romane, 40 përmbledhje me tregime dhe 50 drama përkundër 300 vëllimeve me poezi. Arsyeja e kësaj prirjeje nga poezia, e skajshme për normat perëndimore, qëndron në mungesën e një tradite të fortë të prozës në letërsinë shqiptare përgjithësisht, e pa dyshim në faktin se shkrimi dhe këndimi në këtë krahinë u bë i masave relativisht vonë. Kalimi nga një traditë gojore në poezinë e shkruar, që i ruan në thelb nga e para ritmet dhe tingëllimin e pasur, është bërë më me lehtësi sesa kalimi të veprat e gjata në prozë.⁴

Letërsia shqipe në Kosovë, në shek. XX, njeh një sërë autorësh të rëndësishëm që dhanë një kontribut të pashlyeshëm në zhvillimin e letërsisë shqipe.

Letërsia shqipe në Kosovë do të jetë një vazhdimësi poetike atdhetare gjatë gjithë shekullit XX. Vitet 60-të do ta gjejnë letërsinë shqipe në Kosovë me një vazhdimësi poetike dhe me një plejadë të madhe poetësh që vazhdonin të artikulonin temën atdhetare në format më të larta të poezisë, që në të vërtetë kjo formë e lartësoi poezinë shqipe në përgjithësi. Poezia shqipe në Kosovë solli një pasuri leksikore përmes poezisë së: Besim Bokshit, Adem Gajtani, Fahredin Gundës, Din Mehmetit, Azem Shkrelit, Ali Podrimës, Milazim Krasniqit dhe Basri Çapriqi.

Ky grup poetësh i dha letërsisë shqipe, veçanërisht asaj që zhvillohej në Kosovë një poezi moderne dhe një poezi më të avancuar, që atëherë shkruhej në Evropë. Poetët shprehnin dhimbje, në poezitë e tyre, për fatin e popullit të tyre në kohë dhe në hapësirë. Letërsia shqipe në Kosovë i dha letërsisë shqipe emra të njohur të saj, madje emra të papërsëritshëm në artin poetik të tillë si: Din Mehmeti dhe Azem Shkreli, ku si zë i veçantë qëndronte Ali Podrimja.

³ Robert Elsie - Histori e Letërsisë Shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë & Pejë: Dukagjini 1997, fq. 302.

⁴ Robert Elsie - Histori e Letërsisë Shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë & Pejë: Dukagjini 1997, fq. 307.

Në shoqërinë komuniste shqiptare, dhe jo vetëm në atë shqiptare, kanë ekzistuar ishuj të krijimtarisë së lirë në letërsi, muzikë dhe arte figurative. Në ish-Jugosllavi ekzistonte liria e shprehjes artistike, por kontrollohej në mënyrë mjaft perfide nga komunizmi jugosllav, megjithatë nuk pati atë presion për sterilitet Stalinist, nga i cili do të vuante arti në Shqipëri. Jashtë kufijve të Shqipërisë dhe në diasporë pati lëvizje më liberale me tipare që ngjanin më tepër me letërsinë moderne të traditës sesa si rezultate të një sistemi modern paralel e kompesator. Modelet e jashtëkufirit mbetën lumturisht të paprekura e të pamolepsura nga realizmi socialist dogmatik. Në këtë periudhë dhe duke vijuar edhe më vonë, jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, do të shihnin dritën e botimit vepra me një larushi formash shprehjesh nga shkrimtarë si: Esad Mekuli, Enver Gjergjeku, Martin Camaj, Anton Pashku, Rexhep Qosja, Luan Starova, Resul Shabani, Agim Vinca, Fahrudin Gunga, Din Mehmeti, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Murat Isaku, Kim Mehmeti, Rrahman Dedaj, Ibrahim Berisha, Adem Gashi, Basri Qapriqi etj.⁵

Ali Podrimja është autor i më shumë se dhjetë vëllimeve me poezi dhe mbahet sot nga kritika si përfaqësuesi më tipik i poezisë së sotme shqiptare dhe si një poet me emër dhe në shkallë kombëtare. Botën e vet poetike poeti e artikulon përmes një sistemi figurativ të konsoliduar (veçanërisht me simbolin dhe metaforën) dhe me një shkallë mjaft të lartë ndjeshmërie.⁶

Ali Podrimja lindi e u rrit në Gjakovë. Studioi gjuhë dhe letërsi shqiptare në Universitetin e Prishtinës, ku edhe jetoi. Periudha vendimtare për formimin shpirtëror dhe intelektual të poetit janë vitet pesëdhjetë. Më 1957 botoi poezinë e parë në revistën "Jeta e Re". Ishin vitet kur shqiptarët në Kosovë përjetonin njërin nga terrorët më të egra të pushtuesit serb, kohën e aksionit famëkeq për mbledhjen e armëve dhe të shpërnguljeve më dramatike të përmasave tragjike për Kosovën dhe shqiptarët (rreth treqind mijë të shpërngulur dhunshëm në Turqi). Poeti rritej dhe piquej në këto kushte, në këtë atmosfere agonie, që e kishte mbërthyer Kosovën.

⁵ Luan Topciu, nga libri dorëshkrim "Moderniteti i pamunguar në Letrat Shqipe" (kritikë letrare), fq. 9, Ars Poetica, nr. 5, Mars 2008.

⁶ Fitor Ollomani – Din Mehmeti një zë i veçantë në letërsinë shqipe gjatë shekullit XX, marr nga interneti në uebfaqen www.pashtriku.org

Qyteti i Gjakovës, ku kishte lindur dhe shkollohej, qytet me traditë të pasur patriotike, ishte më i godituri nga kjo vërshimë policore e UDB-së serbe. Poeti i përfshirë në këtë përditshmëri ndjeu nevojë të rezistojë, të kundërvihet dhe ta stigmatizojë tërthorazi synimin e pushtuesit: *Qaj rrafshi im i dashur, qaj!* (fjala është për rrafshin e Dukagjinit) *Diellin tënd verbuar e kanë tytë, E vatrën shkimbur deri më një...* Vargjet janë shkëputur nga poemti lirik “Hija e tokës”, të cilin Ali Podrimja e shkroi në vitin 1960, kur ishte gjimnazist.⁷

Një vit më pas, më 1961, Ali Podrimja botoi përmbledhjen e parë me vargje elegjiake “Thirrje”. Më pas vijnë përmbledhjet “Shamijat e përshëndetjeve” (1963), “Dhimbë e bukur” (1967), “Sampo” (1969), “Torzo” (1971) etj., deri në veprën e tij mjeshtërore “Lum, lumi” (1982), që shënoi një kthesë në poezinë bashkëkohore kosovare.

Në vitet '80 e '90 ai do të vazhdojë të botojë libra poetikë si: Zari, Buzëqeshje në kafaz etj., deri te dy librat në prozë: Burgu i hapur (1998) dhe Harakiri (1999). Kur për një poet themi se nuk është konvencional, pra është modern, këtë duhet ta kuptojmë kështu: Ali Podrimja e çliron poezinë shqipe nga disa rregulla metrike, siç është: vargu i thurur, apo nga përmbajtjet si fryma apologjike, brohoritëse e poezisë së pasluftës etj. Por, ai vendos parime të tjera krijuese, siç është vargu i lirë, shqiptimi metaforik, gjuha e ironisë, efikase për të shprehur zona më të errëta apo më të fshehta të natyrës së njeriut.

Synimi i poetit për t'u fshehur përmes reflekseve ezopike dhe për t'i përcjellë ato, duke shmangur ndalesat e jashtme, e nxjerrin në plan të parë mesazhin dhe në plan të dytë atë pjesë të vlerës artistike që arrihet përmes ritmit dhe euforisë. Me rëndësi është të kuptohet, nëse këto parime poetike të Ali Podrimjes, janë parime të një brezi dhe të një kohe dhe duhet të njihen si përvojë. Pa to nuk mund të kuptohet dhe të zbulohet arti poetik nëpër kohë, sidomos për krijuesit e rinj, poetët e mëdhenj janë shkollë, nga e cila mund të mësojnë; janë përvojat, nga të cilat do të nisin ata të krijojnë parimet e tyre poetike. Poeti Ali Podrimja shfaqet në shkrimin shqip të mesviteve '60, kur hapësira perëndimore e Evropës e mbante lindoren në një farë oborri të mbyllur, apo burg të hapur, por deri në cak të oborrit. Izolimi s'mund të ketë asnjëherë një

⁷ Jeton Kelmendi – Antologji e poezisë moderne shqipe.

“prind” të vetëm, ndërsa zgjatja e tij në kohë e mpak hapësirën, e bën frymëzënëse dhe ul çmimin e lëkurës.⁸

Poezia e Ali Podrimjes, e përkthyer në shumë gjuhë të huaja, është pranuar e vlerësuar pikërisht për arsye se në thesarin universal të vlerave, hyn bindshëm përmes koloritit të veçantë, përmes botës shpirtërore me individualitetin e vet të formuar, të ndryshëm nga të tjerët.

Në vitin 1996 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 zgjidhet anëtar i rregullt i saj. Përmbledhja *Thirrje*, në vitin 1972, u bë mollë sherri për të mos mbetur në qarkullim për një kohë të gjatë, kjo për shkak të disa poezive “hermetike”. Madje si përmbledhje u shpall si e padenjë për sistemin komunist shqiptar, vëlla me sistemin komunist serbomadh. Ekzemplari i shpëtuar nga një poet i qytetit të Tiranës, qëndroi për 20 vite radhazi për të mbërritur në duart e poetit edhe një herë.

Përpos poezive, që janë thelbi i krijimtarisë së tij, Podrimja shfaqet edhe si narrator, eseist dhe publicist. Publikimi i veprës së tij u bë si brenda kufijve të vendit, ashtu edhe jashtë atdheut. Podrimja është pjesëmarrës në shumë manifestime të ndryshme letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai është fitues i çmimeve të ndryshme letrare, nga të cilat po përmendim atë të viti 1999, kur në Shtutgart të Gjermanisë, nderohet me çmimin e mirënjohur *Nikolas Linau*.

Ndërroi jetë më 21.07.2012 në Lodév të Francës, ku merrte pjesë në festivalin e poezisë Voix de la Méditerranée, duke lënë një veprimtari të pasur letrare. Ishte dita kur letërsia shqipe humbet një personalitet të pakrahasueshëm, i cili do ta pasuronte më tej fondin e artë të botës së saj. Tërë poetika dhe natyra e krijimtarisë së Podrimjes e bëjnë të denjë për të qëndruar në nivele të krahasimit me poetët që hodhën themelet e kulturës kombëtare, me ata që i dhanë jetë gjuhës, kulturës dhe kombit. Ai mund të krahasohet me poetët e Rilindjes Kombëtare, por duke mbetur një nga dëshmuesit poetik nga më finët.⁹

⁸ Ardian – Christian Kycyku, U dynd dynjaja dhe gëlltitur mbet nga vargjet (Disa fjalë mbi praninë e Ali Podrimjes në poezinë evropiane), marr nga internet në uebfaqen revistahaemus.blogspot.com

⁹ Fatos Arapi, Në kërkim të lirisë, atdheut, njeriut, parathënie e vëllimit poetik Libri mbi të qenit të Ali Podrimjes, Prishtinë, 2009, fq. 14.

1.1. Veprat poetike të Ali Podrimjes

Thirrje, poezi, Jeta e Re, Prishtinë, 1961; Naim Frashëri, Tiranë, 1972, zgjedhi Pandeli Koçi. Botimi i parë i këtij libri u bë karton.

Loja nën diell, tregime, Jeta e re, Prishtinë, 1967.

Dhimbë e bukur, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1967.

Sampo, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1969; Flaka e Vëllazërimit, Shkup 1980.

Hija e tokës, Bota e Re, Prishtinë, 1971.

Torzo, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1971; Botimi i dytë, pasthënia Ibrahim Rugova, 1979.

Folja, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1973.

Credo, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1976.

Poezi, lektyrë shkollore, Prishtinë, 1978, 1985.

Drejtpehimi, poezi e zgjedhur, parathënia Ibrahim Rugova, Rilindja, Prishtinë, 1981.

Lum-lumi, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1982, 1986, 1990; Toena, Tiranë, 2003, botimi IV dhe V, parathënia dr. B. Kuçuku; Rozafa, Prishtinë, 2003; Libri Shkollor, Prishtinë, 2012.

Fundi i gëzuar, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1988.

Zari, poezi, Rilindja, Prishtinë, 1990.

Në bisht të sorrës, poezi, Art-Pena, Prishtinë, 1994.

Buzëqeshja në kafaz, Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë, Tiranë, 1994; Dukagjini, Pejë, 1995.

Tkurrja e Atdheut, ese dhe të paharruarat, Konica 95, Tetovë, 1996; Toena, Tiranë, 2004.

Libri që nuk mbyllet, ese, Rilindja, Prishtinë, 1997.

Ishulli Albania, Rilindja, Prishtinë, 1998; poezi e zgjedhur, parathënia Visar Zhiti, Onufri, 2004; botimi plotësuar, AIKID, Prishtinë, 2006.

Burgu i hapur, Rilindja, Prishtinë, 1998.

Harakiri, ese, shënime nga esnafi dhe një miniroman, Rilindja, Prishtinë, 1999.

Dielli i zi, ese, Rilindja, Prishtinë, 2000.¹⁰

Poema, Enti i Teksteve, Prishtinë, 1979, parathënia Hysni Hoxha.

¹⁰ Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 183.

Poezi, Naim Frashëri, Tiranë, 1986, zgjodhën Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, parathënia D. Agolli.

Litari i ankthit, poezi e zgjedhur, parathënia Bashkim Kuçuku, Toena, Tiranë 2002.

Antologji personale, Ora, Tiranë, 2002.

Kush do ta vrasë ujkun, Alba-Ass, Tiranë, 2002. Zgjedhjen dhe parathënien Ali Aliu.

Te guri i Prevezës, parathënia Bashkim Kuçuku, Arbëria, Tiranë, 2003.

Letra nga të vdekurit, ese dhe persiatje, Toena, Tiranë 2004.

Pikë e zezë në blu, poezi, Onufri, 2005.

Sfidë harrimit, ese, parathënia Bashkim Kuçuku, Onufri, Tiranë, 2006.

Gjumi i tokës, poezi e zgjedhur, Ideart, Tiranë, 2007.

Fundi i mitit, tregime, parathënia Sadik Bejko, Onufri, 2007.

Libri mbi të qenit, poezi e zgjedhur, Brezi 9, Tetovë, 2008 ; PEN Qendra, Prishtinë, 2009, parathënia Fatos Arapi;

Vepra 1-9, Vepra e plotë, parathënia Ali Aliu, ASHAK, Prishtinë, 2013.

1.2. Veprat poetike të Ali Podrimjes të botuara në gjuhë të huaja

Dozivi, Bagdala, Krushevac, 1968, zgjodhi dhe përktheu në serbokroatisht Esad Mekuli.

Lili i našata sloboda, Nova Makedonija, Shkup, 1968, përktheu në maqedonisht Video Podgorec.

U bogu su nazreli zmiju, Nolit, Beograd, 1972, zgjodhi dhe përktheu serbokroatisht Vehap Shita.

Suzenj pesmi, Lipa, Kopar, 1976, zgjodhi dhe përktheu sllovenisht Ciril Zlobec.

Sonot što produlžuva, Mislal, Shkup, 1978, përkthyen maqedonisht Gane Todorovski, Adem Gajtani.

Zatim belo, Matica srpska, Novi Sad, 1978, përkthyen në serbokroatisht Esad Mekuli, Rexhep Ismajli.

Ravnoteža, Gradina, Nish, përktheu në serbokroatisht Mirko Gashi.

Pesmi, (me Enver Gjerqekun, Azem Shkrelin, Rrahman Dedajn) Mladinska knjiga, Lubjanë, 1980, përktheu në sllovenisht Ciril Zlobec.

Poesie per Lumi, La sfinge, Napoli, 1984, zgjodhi dhe përktheu në italisht Giacomo Scotti.

Gene bir basina, Yalçın yayinlari, Stamboll, 1985, përktheu në turqisht Hasan Merxhan.

Den Wolf satteln, Straelener, 1986, zgjodhi dhe përktheu në gjermanisht Hans Joachim Lanksch.

Baladi Kosova, Tekyn, Stamboll, 1986, përktheu në turqisht Nexhati Zekeria.¹¹

Živjeti, Vesilin Masleša, Sarajevë, 1987, përkthyen në serbokroatisht Hasan Mekuli, Shkëlzen Maliqi.

Nyngtalan Ko, Forum, Novi Sad, 1988; zgjodhën dhe përkthyen në hungarisht: Acs Karoly dhe Feher Ferenc.

Icb saddle das Ross den Tod, Klagenfurt/ Salzburg, 1991, zgjodhi dhe përktheu në gjermanisht Hans-Joachim Lanksch.

Zyc, Orfeu, Varshavë, 1993, zgjodhi e përktheu polonisht Mazllum Saneja, pasthënia Dorota Horodyska.

Das Lächeln im Käfig / Buzëqeshja në kafaz, Klagenfurt/ Salzburg, 1993, përktheu në gjermanisht Hans-Joachim Lanksch u ribotua në vitin 2004.

Wandern mit dem Wolf, Weiser Verlag, Klagenfurt-Salzburg, 1992, zgjodhi dhe përktheu në gjermanisht Hans Joachim Lanksch.

Poeti Europei, Centro Italiano Arte e Cultura, CIAC- Roma, 1998.

Who whill slay the wolf, selected Poetry by Ali Podrimja, Gjonlekaj Publishing, Nju Jork, 2000; zgjodhi, përktheu në anglisht dhe shkroi parathënien, Robert Elsie.

Défaut de verbe, Edition bilingue, Cheyne, Le Chambon-sur-Lignon, 2000, përktheu në frëngjisht dhe shkroi parathënien Aleksander Zoto.

Skradziony p?omie?, Pogranicze, Seyni, 2007, wybór?ad z języka alba?skego i poslowie Mazllum Saneja, opracowanie i wespół?praca Ewa ?meta?ska.

Deserto invasivo, poesie, a cura di Bl ;erina Suta, De Angelis Editore, Avelino, 2007.

Cartea ce mu se inchide, Anthologie de autor, Librarium Haemus, Bukuresht, 2007, antologare, traducere ?i aparat critic de Kopi Kyçyku cu o prefat? de Ardian-Christian Kuciuk.

¹¹ Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 184/

Flaka e vjedhur/La flamme volée, L'Arbre à paroles / Residences, 2010, traduction Vasil Çapeqi, adaptation Francis Chenot.

??i?meno? xapt?? (Harta e grisur), Eolika grammata, 2011, përktheu në greqisht Iliaz Bobaj.¹²

1.3. Panorama dhe antologji në gjuhë të tjera

Poezia e Podrimjes ka zënë një vend të rëndësishëm në antologji të ndryshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera.

Vertikale (me Augustin Stipčevićin), Matica Hrvatska, Split, 1970.

Duboko je korijenje (me Augustin Stipčevićin), Matica Hrvatska, Split, 1970.

Le parole rinato – Fjalë të rilindura – (me Giacomo Scottin), Rilindja, 1970.

Kiša u jednoj legendi, Prosveta, Beograd, 1973.

Bez glagola, August Cesarec, Zagreb 1978.

Poezia acontemporano di Jugoslavia, Libertates, Pançevë 1978.

Poeti albanesi in Jugoslavia, La Battana, Rijeka 1978.

Dega e pikëlluar (me Sabri Hamitin), Rilindja, 1979, në gjuhët gjermane, frënge, angleze dhe arabe (Kuvajt).

Poezia revolucionare e popujve të Jugosllavisë (me P. Matvejeviqin, H. Tahmishiçin, S. Lluçiçin, C. Zlobecin), Spektri, Zagreb 1981.

1.4. Ali Podrimja në panorama e antologji shqiptare e në gjuhë të huaja

Shtigjet e qëndresës – Stazama otpora (grup përpiluesish), Klubi i punëtorëve letrarë të Kosovës, Prishtinë 1961¹³

Pesme gorke i ponosne (akad. Esad Mekuli), Nolit, Beograd 1962

Panoramë e letërsisë bashkëkohore shqipe në Jugosllavi (grup përpiluesish), Enti i Teksteve, Prishtinë 1964

¹² Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 185.

¹³ Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 185.

Pravostoina (A. Gajtani dhe G. Todorovski), *Makedonska knjiga*, Shkup 1968
Tregime të sotme shqiptare, (Ramiz Kelmendi), Prishtinë 1969
Për ty, Poezi nga Kosova në botim të Naim Frashërit, Tiranë 1969
Rrëfimi i njeriut me samar, panoramë e tregimit kosovar, Naim Frashëri, Tiranë 1970
Antologjia e lirikës shqipe (akad. Rexhep Qosja), Rilindja, 1970 dhe *Enti i Teksteve*, 1985.
Cormoran y delfin (14 poetë kosovarë në spanjollisht), Buenos Aires, 1971
E di një fjalë prej gurit, *Antologji e poezisë së Kosovës*, Naim Frashëri, 1972
Trolli betohet (Dr. Hysni Hoxha), Rilindja, 1975.
Beschwingter Stein (zgjedh e përkthyer Ina Jun Brod). *Poezi bashkëkohore e Jugosllavisë*, Wien – Mynchen, 1976.
Regen in einer Legende (zgjedh e përkthyer Dieter Schon), Heiligenhof, 1977.
Antologjia e poezisë së sotme shqipe në Jugosllavi, Jehona, Shkup 1977.
O?i kamena – Sytë e gurit (akad. Esad Mekuli), Pobjeda, Titograd 1978.
Arnavut siiri antolojisi (Ibrahim Rugova), Tan, Prishtinë 1979.¹⁴
Sla po soncu (Hasan Mekuli), Cankarjeva Založba, Lubjanë 1979.
Antologjia i komentari savremene jugoslovenske misaone poezije, Grafos, Beograd 1980.
Antologjia e poezisë jugosllave (Nexhati Zekekrija) Xhem, Stamboll 1980.
Ljudi bez oružja, *Antiratna poezija*, *Nova knjiga*, Beograd 1985.
Iz savremene albanske poezije (Dr. Agim Vinca), Sarajevski dani poezije, Sarajevë 1985.
Pisatelji za demokracijo, *Mladinska knjiga*, Lubjanë 1989.
Antologjia e poezisë së përshpirtshme shqipe (Zgjodhi Anton Nikë Berisha), 1999, Prishtinë.
Poesia del Kossovo (përgatitur nga Daniele Giancane), italisht, 1999.
Gui anh ngoi Kosovo (Përshëndetje vëllezërve kosovarë), vietnamisht, Trinn Bay, 1999.
Antologjia e poezisë shqipe shek. XX (Zgjodhi e përktheu: Kun Stasejns), flamanisht, Amsterdam, 2000.
Antologji e poezisë shqipe (Ali Aliu), 2000, Tetovë.
Katër poetë (Zgjodhi e përgatiti Xhevahir Spahiu), Tiranë, 2000.

¹⁴ Ali Podrimja, *Vepra 1*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 186.

Nie jest za pó?nona mi?o??, Antlogia poezji albanskiej XX wieku, përgatiti dhe përktheu Mazllum Saneja, Pogranicze, Sejny, 2005.

Ali Podrimja, A split stone, An Antholgy of Albanian Poets of Kosova, translated from Albanian, Avni Spahiu, DIÇ&Rozafa, Prishtinë, 2006.

Luan Topçiu, O antologie a poeziei albaneze, Editura Privirea, Bukuresht, 2007.

Bashkim Kuçuku, Ukraden plamen, Antologija albanske poezije, përktheu Qazim Muja, DANU, Podgorica, 2009.

1.5. Çmimet vlerësuese për krijimtarinë e Ali Podrimjes

Krijimtaria e Podrimjes me vlerat estetike, tematike dhe ideore që mbart është vlerësuar me shumë çmime, ndër më të rëndësishmet mund të përmendim:

- Çmimi i Dhjetorit, i Nëntorit, (i qytetit të Prishtinës), i Rilindjes, i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Fjalës etj.
- Çmimi ndërkombëtar për poezi “Nikolaus Lenau”, Shtutgart, Gjermani, 1999,
- Çmimi ndërkombëtar “Liburna”, Durrës, 2005.
- Çmimi Azem Shkreli.
- Çmimi i Organizatës Kulturore Ndërkombëtare “Kafeneja e Ideve”, Salaminë, Greqi, 2011.¹⁵

Poezitë e tij janë përkthyer edhe në hebraisht, danisht, norvegjisht, holandisht, greqisht, çekisht, bullgarisht etj. Po ashtu janë botuar në revista, si: *Poesis 93*, *Mediterran* (Paris), *Neue Sirene* (Mynhen), *Neueliteratur* (Ofefenbach), *Literatur und kritik* (Salzburg), *Hid* (Novi Sad), *Slobodnost* (Lubjanë), *Impegno 80* (Itali, Mazara del Vallo, Frapani), *Literatura na swiecie* (Varshavë), *Život* (Sarajevë), *Nëntori dhe Letërsia shqipe* (Tiranë), *Književnost* (Beograd) etj. Për poezinë e tij kanë shkruar: Hasan Mekuli, Vehap Shita, Ali Aliu, Rexhep Qosja, Rexhep Ismajli, Bashkim Kuçuku, Xhezair Abazi, Gani Bobi, Mensur Raifi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Anton Berisha, Basri Çapriqi, Hysni Hoxha, Sali Bashota, Visar Zhiti, Faruk Myrtaj, Milazim Krasniqi, Vehbi Bala, Perikli Jorgoni, Abdullah

¹⁵ Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 189.

Konushevci, Rrahman Paçarizi, Jusuf Buxhovi, Ali D. Jasiqi, Shefqet Riza, Asllan Selmani, Ismail Syla e shumë të tjerë, shqiptarë e të huaj.¹⁶

¹⁶ Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 190.

Kreu II

2. Ali Podrimja zë i veçantë në letërsinë shqiptare

“Ali Podrimja bën pjesë në bërthamën e poetëve që hyjnë në letërsinë shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX dhe që me dhimbje dhe mundime prometeiane hap udhën për një zhvillim të fuqishëm të poezisë sonë.”¹⁷

Podrimja me plot të drejtë konsiderohet, një ndër poetët më të shquar shqiptar dhe më përfaqësues në botë. Kryetëmë e poezisë së tij është dashuria për jetën dhe atdheun, shpresa për një jetë më të mirë, që përbën kushtin ekzistencial të metaforave, epiteteve dhe thënieve në formë alegorike. Studiuesit me të drejtë konstatojnë se poezia e Podrimjes është dëshmi e një vetëdijesimi kolektiv në luftën për liri e pavarësi që nga vitet e ‘60 e respektivisht në vitet e ‘80, ku poezia e tij u bë zë i përgjithshëm i popullit. Poezia e Ali Podrimjes është një kaptinë e veçantë në letërsinë bashkëkohëse shqipe, sepse është ngjarje e hidhur e dinamizmit të gjithanshëm të psikikës njerëzore. Ali Podrimja, ky poet i dhembjes dhe i durimit, i revoltës dhe i rezistencës gjithnjë synon të kuptojë thellë qenësinë e fenomeneve dhe të gjërave, depërton në substancën shpirtërore të ngjarjeve dramatike, duke u futur në kuptimin e ekzistencës si të njeriut, ashtu edhe të gjërave.

Vepra poetike e Podrimjes është një tërësi të përbërë, e ngjeshur, e kristalizuar, konsekuente dhe e saktë. Kjo është një poezi e një niveli të lartë dhe e një dimensionit të jashtëzakonshëm etik, që ngërthen në vetvete respektin e thellë për njeriun e rëndomtë, për thjeshtësinë, guximin dhe nderin. Heroi i Podrimjes tërë kohën gjendet në një situatë të zgjedhjes: identiteti i tij është i definuar ekskluzivisht si qenie dramatike ndërmjet mitit dhe realitetit, traditës dhe bashkëkohësisë, idesë dhe konkretes, mendimit dhe veprimit.

Ali Podrimja si një poet i kursyer në fjalë, i papërsëritur në sintaksën poetike, është një poet me shpirt të trazuar, gjithnjë në kërkim të mjeteve të reja të shprehjes artistike, përmes një gjuhe provokuese. Poezinë e tij e karakterizon një gamë e gjerë e problematikës dhe një shumëllojshmëri e mjeteve shprehëse. Podrimja është poet i revoltës dhe i rezistencës, gjithnjë në

¹⁷ Fatos Arapi, Në kërkim të lirisë, atdheut, njeriut, parathënie e vëllimit poetik Libri mbi të qenit të Ali Podrimjes, Prishtinë, 2009, fq. 5.

luftë me të keqen, me mizorinë, barbarinë dhe më në fund në luftë me sëmundjen, vdekjen. Ai solli në poezinë moderne shqipe një ndjeshmëri dhe intonacion të ri poetik. Në veprat e tij poeti nuk shtron vetëm probleme të ekzistencës kombëtare, të etnisë dhe të atdheut, të realitetit të hidhur të kohës, po ai shtron probleme universale të ekzistencës njerëzore të rëndësishme në luftën e individit përballë sistemeve totalitare për liri dhe demokraci, të individit të mbërthyer me trauma e kriza gjithfarëshe, në kohën që karakterizohet si shekulli i qytetërimit teknik, po edhe i shkatërrimeve më të mëdha njerëzore, për të cilat dëshmon historia. Studiuesit e poezisë së tij theksojnë se ai nuk pushoi së shkruari edhe atëherë kur “kohë t’egra trokitën pullazeve tona gërmuqe” dhe kur “buzëqeshja u mbyll në kafaz”. “Dodona”, “Ura e Shenjtë”, “Molla e Kuqe”, “Guri i Prevezës”, “Janina”, “Tomori”, “Pashtriku”, “Korça”, “Ohria”, “Joni” etj., ishin toponime të shpeshta të poetikës së tij, Shkodra, Gjakova, Shkupi, Vlora, Kruja gjithashtu.

Ali Podrimja si poet do të mbahet mend si njeri që krijoi një libër të rrallë me poezi në gjuhën shqipe, vëllimin poetik “Lum Lumi”, të botuar për herë të parë në vitin 1982 në Prishtinë dhe të ribotuar shumë herë të tjera më vonë, të përkthyer edhe në shumë gjuhë të tjera të botës, posaçërisht të Ballkanit dhe Evropës, si pjesa dërrmuese e poezisë së tij. Sëmundja e më pas edhe vdekja e të birit të poetit, Lumit lanë gjurmë të thella në zemrën dhe mendjen e autorit. Që nga ky çast, poezia e Podrimjes pati një ngritje kulmore në aspekt të cilësisë dhe vlerave. Me këtë vepër, arriti që të inkadrohet në mesin e autorëve botërorë, duke qenë pjesë e antologjive të ndryshme, nëpër vendet e ndryshme të botës. Podrimja me plot të drejtë konsiderohet, një ndër poetët më të mirë shqiptar dhe më përfaqësues në botë.

Ali Podrimja, te kryevepra e tij, Lum Lumi (1982), në tekstet e rralla personale, ashtu siç do e bën letërsia moderne, universalizon kontekstin personal, referencat e rënda të jetës, tragjedinë e humbjes së djalit e dhimbjen që s’mbaron kurrë. Kjo poezinë e tij personale e bën universale, dhimbjen e babës, dhimbje që mbështjell universin, rrëfimin e dhimbjes, figurë që shënjon jetën. Teksti i prerë në blloqe të një kronike që shoqëron sëmundjen e djalit hapet i ftohtë e i zyrtë, shenja që bëjnë ontos-in e tij. Ky ontos na largon nga referencat e para të shkrimit e të dhimbjes, drejt dhimbjes që hapet në leximin e secilit, qoftë dhe kur lexuesi s’e njeh kontekstin personal të veprës së Podrimjes. Shenjat e mëdha letrare e emocionale, Lum Lumin e çojnë në katrorin e elegjisë, që kryqëzohet me dhimbjen. Por gjëma nuk ndihet në zë, meqë shtrihet në figura, në zymtësinë e diskursit, në paradoksin e shkrimit që do ta zbrazë dhimbjen

kur e shkruan duke i fshehur figurat. Hapjen më të madhe gjëma e Podrimjen e ka kur zbulohen figurat ambientale, të cilat janë plot me kulturën fatidike të vajit e të gjëmës shqiptare. Këto shenja sikur duan të thonë se letërsia si kjo e Podrimjes ruan iluzionin për ta bërë dhimbjen kulturë, kur e shkruan atë si kulturë. Nëse e pakëson kur e shkruan, tepër e vështirë të thuhet e të shkruhet. Në anën tjetër, tradita tridhjetëvjeçare e leximit të kësaj veprë, paprerë e ka parë atë në kontekstin personal e nën shenjat e së vërtetës së jetës së Podrimjes. Tema e rëndë dhe fara personale e literaturës leximin e tillë e kanë lidhur me biografinë, që, vërtet, është një lidhje me kontekstin personal të autorit, pa e zbritur në lexime sociale e ideologjike. Duket hapur në leximet me shkrim të *Lum Lumi* se vepra e ka transmetuar fort zinë e dhimbjen e shkruar, madje të jetuar. *Lum Lumi* ka katër cikle. I dyti, *Të jetosh*, është më i bukuri poetikisht e më i rëndi tematikisht. Ai është një perlë e zezë e veprës, ndërtuar nga poezitë për *Lumin* e përfshirë në qerthullin e vdekjes. *Lumi* e kapërcen këtë kufi, “derdhet” tej, ndërsa baba/poeti e provon vdekjen për së gjalli. Figurat e Podrimjes te ky cikël burojnë nga emocioni, nga dhimbja. Kur hapet figura, takohet emocioni e njihet thellë dhimbja. E shoqëruar nga një fatalitet pa rrugë të dytë, figura e Podrimjes merr shenjën e një figure mitike. Vaji i Podrimjes bëhet vaj i qyqes, si në etosin e dhimbshëm shqiptar. Figura e tillë s’është dekor i temës e i strukturës, por esencë e tyre. Kur lexohet figura, lexohet zemra e qerthujve semantikë të poezisë së Ali Podrimjes. *Lum Lumi* i bashkohet rrjetit të elegjive për njerëzit e dashur, të shkruara kudo e në çdo kohë. Por si të gjitha veprat e tilla, *Lum Lumi* e provon se askush nuk mund të vajtojë për *Lumin* si Ali Podrimja. Kjo vepër vetëm përjetohet nga të tjerët, më shumë a më pak, në leximet e secilit. Ajo hapet me frymën e me zinë e saj para shpirtit që ndjen. Emocionet e rënda reflektojnë ide të rënda, që, përtej racios, nisen drejt shpirtit të lexuesit. Kush e lexon *Lum Lumi* i hyn aventurës së rëndë për ta njohur Ali Podrimjen, gurët e rëndë të jetës së tij, frymën e dhimbjen, Ali Podrimjen e kthyer nga vetja, madje njëjën universale të poezisë së tij. Kthimi nga vetja është hyrje në vetënjohje, shpalim i qenies në ontos poetik, në një estetikë të rrallë, që e rrallë është edhe pse tekstin e bën quid unicum, një ontos të cilit i mjafton vetja e hapet për të tjerët. Në këtë estetikë, leximet më autentike janë ato të teksteve pa kontekste.¹⁸

Me librin *Lum Lumi*, Podrimja ka treguar se është mjeshtër i shkëlqyer i zhvendosjes dhe i alternimit të konteksteve nëpërmjet ndërtimit të hapësirave dhe nënhapësirave. Varianti i

¹⁸ Akademia e Shkencave të Kosovës, Studime – Revistë për studime filologjike, Prishtinë, 2014, fq. 187.

Lum Lumit të vitit 1986 shfaq një poetikë që priret drejt një vargu të fragmentarizuar, saqë në shumë raste si nyje lidhëse mes tyre mund të shërbejnë temat, motivet tematike, madje edhe vetë subjekti lirik. Aty – këtu dominon prirja për defigurim të gjuhës dhe shndërrimin e saj në një gjuhë të të folurit të përditshëm.¹⁹

Poezia e tij është dëshmi e një vetëdijesimi kolektiv në luftën për liri e pavarësi që nga vitet e '60 e respektivisht në vitet e '80, ku poezia e tij u bë zë i përgjithshëm i popullit.²⁰ Ali Podrimja, njëherit njihet edhe për gjuhën metaforike, e eksperimentale, që në përmbajtje ka urtitë e kulturës gojore. E gjithë poezia e tij, merr shembuj anekdotikë e përrallorë, të shoqëruara me karakterin historik të origjinës së hershme të shqiptarëve që nga ilirët deri në ditët e sotme. Ai ka një sistem të të folurit ku urtitë dhe proverbat, krijojnë një lirizëm epik, që me eksperimentimet formale të kulturës sintaksore, bën që vepra të marrë një kahje krejtësisht tjetër, nga hapi fillestar, duke iu përshtatur realitetit. Mbi të gjitha Podrimja njihet për ndjenjën e bashkëshoqëruar me një durim të pashterur për të paraqitur sa më qartë figurën e shndërruar në mit. Duke qenë poet bashkëkohor, Ali Podrimja e çliron poezinë shqipe nga kornizat konvencionale, duke i dhënë shprehje të lirë vargut, shprehje metaforike, shprehje ironike që vënë në pah idetë dhe mesazhet e tij artistike.

2.1. Arti poetik i Ali Podrimjes

Poezia e Ali Podrimjes, në rrafshin e komunikimit artistik, si poetikë e sistem komunikues gjuhësor, por edhe stilistikë, në botën letrare shqipe, paraqitet e veçantë, karakteristikat e së cilës dallohen në strukturën e vargut, por më fuqishëm, në rrafshin e ideve. Në rrafshin e elementeve konstituive poetike, kjo poezi, me shtresën e tingujve dhe cilësitë ritmike, shpërfaq tekstualiet të gjallë e dramatik. Podrimja, duke qenë poet me perceptime të thella, me botë të pasur imagjinatave e inovacion të bujshëm artistik, përmes asociacionit të imazheve dhe figurave, konfiguron vargje lakonike, ku shquhet, përveç tjerash, mprehtësia dhe thellësia filozofike e mesazhe, të cilat konotojnë dhe kështu, shtresojnë elementet bazike të një poetike moderne, përmasat e së cilës poetikë, vazhdojnë të përcjellin tendencat avancuese në

¹⁹ Ramadan Musliu, "Poezi e ndjenjës së rëndë", Prishtinë 1986, fq. 4.

⁺²⁰ Zymer Mehani – Poezia e Ali Podrimjes.

artin poetik. Autori luan mjeshtërisht me simbole dhe metafora, të cilat i vesh me shtresa tekstesh a figurash arkitekstuale, të cilat marrin statusin e shenjave poetike, të shënuara poetike, që përcjellin mesazhe dhe funksionalizojnë perceptimet e poetit, për dukuritë të cilat i shkruan. Gjitha këto elemente poetike, i japin poezisë së tij një impuls të veçantë në kuadër të poezisë shqipe.

Poezia e Ali Podrimjes artikullohet përmes një sistemi figurativ të përpunuar, e të konsoliduar, ku ndeshim figurat stilistike të fuqishme, me një predominancë të metaforave dhe simboleve, që enden se shënjuese të stilit podrimjan. Poeti, stilin dhe diskursin e tij poetik e ndërton duke harmonizuar ndjeshmërinë dhe përvojën letrare si eksperiencë. Kjo e bën poezinë e tij universale, sado që ajo të shumtën e herëve, frymon nëpër ambientin shqiptar, motivohet prej tij dhe ka qëllim intencional përmbushjen e misionit të pikasjes së historisë së qenies shqiptare në poezi.

Në relacion poetik, mes subjektit (poetit) dhe objektit, gjithmonë ekziston empiria letrare e cila merr status të fuqishëm; autori i shmanget patetizimit poetik dhe ndërton tipin e poezisë me përplotë ekuivokë, ku shquhet sidomos mendimi i thellë.

Poezia e Podrimjes, në esencë, shtreson ide e situata që paraqesin shpirtin e trazuar të subjektit, kundruall universit të pafundmë, në të cilin lundron imagjinata e tij poetike dhe thithë përvojat me specifike të këtij universi. Për të realizuar pastaj, përmes shenjave poetike, biblën e tij të jetës, diskursin e shumëllojshëm poetik dhe semantikën e jetës si art dhe artit si jetë. Poeti Podrimja gjithnjë kërkon të gjejë mjete të reja të shprehjes artistike, andaj edhe tipi i poezisë së tij gjithmonë del i freskët, stili evolues.

Në poezinë e tij ndeshim një gamë të gjerë temash e problemesh, por edhe shumëllojshmëri trajtash e mjetesh ligjërimore. Podrimja, herë del si poet i revoltës dhe i rezistencës (për të shëmbëllyer me Migjenin e Nolin), herë me shpirtin e pasionuar të rrëfimit homerik (për të shëmbëllyer me Gjergj Fishtën). Idealet e tij poetike, përveç se kanë qëllim funksional, ato korrespondojnë thellë, në këtë kontekst me poet të mëdhenj klasikë shqiptarë.²¹

²¹ Ndue Ukaj – Poezia e Ali Podrimjes.

Është mendim i pranuar në kritikën shqipe se Podrimja në poezinë bashkëkohëse shqipe solli një ndjeshmëri dhe intonacion të ri poetik, një tip të poezisë që kërkon esencat dhe i manifeston përmes gjuhës së goditur e figurave të përpunuara.

Në librin me poezi “Pikë e zezë në blu”, (Onufri, Tiranë, 2005), poeti Podrimja qysh në titull sikundër shpalos platformën poetike, kur konfronton dy figura poetike të fuqishme, figura këto të cilat dalin në kontrast të pazakonshëm; dy figura që janë ngjyra të ashpra të krijimtarisë së tij poetike: e zeza, si personifikim i së keqes, element që shtresohet në dimensione kërkimore e intecionale, dhe e kaltra si ngjyrë lumturie, e njollosur nga pika e zezë, e cila prish harmoninë dhe bukurinë estetike, tash jo vetëm të poezisë, por edhe ekzistencës së poetit. Pika e zezë në blu, është metaforë për vërsuljet që iu bëhen lumturisë së poetit, dashurisë, harresës, por kjo pikë e zezë në blu bëhet shenjë estetike e kondensuar dhe me nuanca emocionale, prej së cilës sajohet një tip i poezisë së mendimit të thellë dhe filozofike. Këto vërsulje, autori i nxjerr herë nga subjektiviteti personal, e herë-herë nga ndjesimet kolektive, nga fatet dhe fatkeqësitë e kombit të tij, nga mjerimi, i cili siç shprehet ai “të lë pa u larë”. Për të shpërthyer në poezinë “Biblike” që e hap këtë përmbledhje, me një mlllef të papërmbajtur, por të realizuar poetikisht: “Në tokën tënde/ të qosh jetë refugjati/mallkim gjaku”.

Bota letrare e poezisë së Podrimjes është e gjerë. Ajo shtrihet nëpër hapësira etnike e universale, ndërsa autori fatet e popullit të tij, që janë edhe fatet e tij, i pikasë me trajta të fuqishme retorike, ku metaforat dhe figurat e mendimit krijojnë imazhet universale, herë të trishta, e herë gazmore.

Ky libër poezish, është i ndarë në pesë cikle poetike: Imazhe i akullt, Maratonë nga Iliria, Mes ujit të madh dhe ëndrrës, Pikë e zezë në blu, Bregu ja errët, të cilat shtresojnë një numër vjersha të botuara nëpër kohë të ndryshme, e në të cilat poeti rrekët së trajtuar për fenomene të ndryshme të qenësisë së njeriut dhe përpalljes së tij me fatet e jetës. Poezia shikuar përgjithësisht, evokon situata e fenomene që lidhen me gjendjen e kombi të tij, veçanërisht Kosovës. Poeti evokon situata të ndryshme ekzistenciale, të cilat në sensin “gjykues të pietetit” marrin attribute revoltuese. Për të funksionalizuar këtë, inkorporon në vargje figura të dendura sarkastike, përmes një gjuhe që nuancohet me shenja humori të hidhur: autori është i shqetësuar për trendët e kohës nën qiellin e tokës së tij, pastaj hedhet në revoltë therëse, siç del tek vargjet: *Lehje atje poshtë: U ka dalë zëri/ Heronj apo brejtës*. Poeti Ali Podrimja, përmes metaforave të

dendura dhe sistemit gjuhësor të përpunuar me mjeshtëri artistike, hedhet ne furtunat e jetës dhe sfidon kohët, duke u trandur në shpirt, siç del tek vargu: “Delja e livadhit shëtiti Njeriun”. Kjo metaforë dhe ky mesazh poetik, si kontrast figurativ, sfidon të bukurën dhe godet ashpër dukuritë që e dezorientojnë njeriun e kohës. Prandaj edhe trishtohet nga “Përmendorja e viçit”: *Viçi ynë më në fund/ Meriton një përmendore.*

Në letërsinë shqipe, Podrimja njihet si poet, i cili kultivon vargun e kondensuar, me një sistem figurash e trajtash retorike që çrendomtësohen (nacion i formalistëve rus) nga trajtat konvencionale të poezisë shqipe. Në këtë segment, poeti hedhet në krah të tendencave të transformimit të strukturës poetike; autori nga tipi i ligjërimit të zakonshëm, kalon në ligjërime atributive, ku ndeshim sistem të përpunuar figurash e trajtash poetike, në të cilin plan, rrafshi estetik, pa asnjë shmangie mbetet esencial dhe predeterminedues.

Poezia e Ali Podrimës i përket korpusit të poezisë shqipe që ec në rrafshin e ecjes pas novatores dhe tendencave të hapura të poezisë. Modernia (si koncept që shënjon shkëputje nga tradita dhe shënjon prurje të reja) në poezinë e Podrimës, është e dukshme. Kështu që në letërsinë shqipe iu bashkëngjiten një plejade të tërë poetësh të mirëfilltë, të cilët ditën t’i shmangeshin ideologjisë në art e jetë (kujtojmë Mirko Gashin, Azem Shkrelin, Fredrik Reshpjan, Visar Zhtin, etj.).

Poezia e Podrimës, vargjet në përgjithësi janë sintetike. Përveç tjerash, atë e karakterizon nganjëherë një dimension ironie, i pulsuar nga dridhmat dhe tronditjet e poetit kundrejt tyre.

Kështu tek poezi “Nëna zbret në zemër të dheut”, poeti esencat e botës së ndjeshme të tij i rumbullakon tek zhbërja, nga e cila ka ankth: “Edhe fjala e fundit kur më tha/gabimi i identitetit si hije më ndjek/ e unë zihem me ligjet”. Në këtë sens, autori ndjehet i irrituar me pozicionin e qenies të tij nacionale midis dy qytetërimeve, prandaj me dele thotë nuk dilet në Pazar/ prandaj edhe litari e ka lidhur lak/ duke mos e mbajtur as lëshuar. Basri Çapriqi duke e ndarë në faza poezinë e Podrimës, poezinë e tij të viteve ‘70 e quan si fazë të ekonomizimit maksimal të shprehjes dhe të komunikativitetit të vështirësuar. Në këtë fazë — autori lë një

traditë shkrimi, bën shmangie të madhe stilistike dhe me shmangien e vet bën që të krijohet një shmangie e madhe në poezinë shqipe në përgjithësi.²²

Gama e interesimeve poetike të Podrimjës është e gjerë, prek tema e probleme të kohës, të shkuar dhe të së ardhmes. Objekti i tij artistik, korrespondon me situata aktuale, por edhe të së kaluarës. Poeti jep krizën e përgjithshme me bota të fuqishme, kund edhe me diskurs dramatik. Në këtë aspekt, vlen të përmendet poezia “I marri sokaqeve tona”, ku me shtresa të ndryshme motivesh, autori përplasë në vargje fatin a “kasdabnës sonë”. Gjitha këto kanë një dimension të fuqishëm ironik.

Poezia e Podrimjes referencën inspiruese e ka shpeshherë nëpër ambientin shqiptar, e ndërlihd kund e kund me personalitete të rëndësishme historike dhe këto i vënë funksion të intencionalitetit poetik.

Tek poezia “Udhëtimi nëpër pyll”, poeti ka frikë nga të panjohurat, andaj obsesioni i tij shpërthen hovshëm: Kujdes se Malin e pa shkelë/Mund ta terrojnë dhe perënditë/e dot ta gjesh/Itakën. Për të ikur ndonjëherë nga temat e rënda, poeti nuk lenë pa prekur edhe tema intime, e cila temë, edhe pse nuk paraqitet në shumësi, karakterizohet për vlera universale (poezitë Cunami nën Çarçaf si dhe Përflakja e trupave).

Shikuar përgjithësisht, Ali Podrimja poezinë jo vetëm se e ka vokacion, por atë e kultivon me shije të hollë artistike. Në strukturën e poezisë së tij kemi një ligjërim poetik të avancuar, me trajta shumëformëshe shprehëse. Përveç se e ka esencë të ligjërit figurën dhe goditjet e fuqishme e ironike, fjalëformimin i tij i ndërtuar kryesisht me vargje lakonike, në gramatikën poetike të së cilit inkorporon një gjuhë të gjallë. Në këtë aspekt, kodet dhe diskurset shumëformëshe kulturore e letrare, me ide e motive të nduarndurëshme, sintetizojnë portretin e një poeti të madh dhe produktin e tij- një poezi universale.

Në lartësinë e vet artistike poezia e Ali Podrimjes shkëlqen misionare: poeti që nga fillimet ka gjakuar të jetë zë i dhembjes kolektive kosovare, vizion që mund të konsiderohet edhe si një ndërmarrje donkishoteske e llojit të vet, e zëri i tij poetik do të jetë thellësisht tronditës, i mprehtë, i qëndrueshëm, bartës i dhembjeve së të gjithëve. Prandaj poezia e tij, e përcaktuar, e

²² Basri Qapriqi, Simboli dhe rivalët e tij, fq. 151.

lindur në valët e këtij shqetësimi dhe misioni nuk do të jetë në asnjë rrethanë një latent dëshpërues, i pashpresë i vuajtjes dhe dhimbjes, por përkundrazi, vargu i tij do të jetë mobilizues në drejtim të mbrojtjes së frymës, do të jetë një mburojë e shpirtit kolektiv gjatë vuajtjeve epokale të popullit të vet dhe poezi pa të cilën vuajtja dhe dhembja do të ishin tragjike, të pashpresa dhe absurde. Ali Podrimja si poet kërkon dhe zbulon sferat, shtyllat mbajtëse më vitale brenda këtij oqeani vuajtjesh, duke shpalosur në artin e vet poetik burimet e shpresës dhe qëndresës.²³

2.2. Realiteti jetësor në poezinë e Ali Podrimjes

Historia e njerëzimit ka njohur shpesh periudha kur fjala e poetit ndikoi në jetën e përditshme. Ky rol është arritur sidomos përmes polemikave shoqërore (shembull madhështor tek ne mbetet Fishta). Ato përfshinin shkrimtarë, gazetarë, artistë dhe politikanë, zgjonin interesim dhe përsiatje të ndryshme. Këto polemika nuk qëndronin vetëm në rrethin letrar, por përfshinin aspekte të ndryshme të jetës politike dhe shoqërore. E kam fjalën këtu për ato situata që kërkojnë të ndërtojnë një shoqëri të mirë dhe të lirë.

Një figurë intelektual e mirëfilltë dhe e rrallë që edhe Ali Podrimja. Ai nuk njihet vetëm si njëri nga poetët më frytdhënës të letërsisë sonë bashkëkohore, por arriti të shndërrohet në zëdhënësin besnik të njeriut të tij, duke zgjidhur në mënyrë origjinale raportin historik me ndjenjën qenësore dhe shpresën për ndryshim, pa e hequr vëmendjen nga modelet mitologjike të popullit shqiptar. Podrimja mishëron figurën e intelektualit të angazhuar në shoqëri dhe arti i tij e pasqyron këtë mjaft qartë. Për Podrimjen konceptet jetë dhe poezi janë sinonime.

Ai i takon atij brezi të poetëve të formuar në vitet '60 për të cilët poezia ishte jo vetëm shprehje intime, por edhe pasqyrë e përparimit dhe angazhimit.

Padyshim se idiolekti poetik i Podrimjes na mundëson interpretime dhe lexime të ndryshme, por do të ndalem kryesisht tek koncepti “poet i angazhuar në shoqëri”. Na e lejon këtë, jo vetëm vepra e tij e gjerë, por edhe veprimtaria letrare e publicistike.

²³ Ali Podrimja, *Vepra 1*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2013, f. 8.

Podrimja jo vetëm u angazhua për fatin e shoqërisë në të cilën jetoi, por ai luftoi vazhdimisht që të mos mbizotëronin antivlerat dhe antihumanizmi. Ai i përgjigjet mirëfilltë portretit të intelektualit bashkëkohor të përcaktuar nga Bernandelli “Në epokën e mbi-komunikimeve, njeriu i veprimit, aktivisti, intelektual i angazhuar shndërrohet në njeri ose Mbi-njeri i komunikimit, Herkul ose Sizif i masmedias”.

Podrimja cilësohej para se gjithash nga shpirti i pastër i revoltës dhe e ndjente mirëfilltë përgjegjësinë dhe rolin e intelektualit përpara shndërrimeve të vrullshme, por edhe delikate, të shoqërisë.

Qysh në fillimet e tij krijuese ai iu përgjigj me refuzim dhe shpirt revolte pushtetit të padrejtësisë. Duke jetuar fazat e pasluftës së ish-Jugosllavisë (përfshirë krizën ideologjike) dhe ato që Kosova e tij kaloi për të mbërritur në statusin e saj të pavarur, Podrimja dëshmoi se cili duhet të ishte roli i njeriut të kulturës: Në rrugën e verbër/rri ndez vetëm/një llambë.

Poezia e tij është epitomë e hermetizmit ku metaforat përbëhen nga disa nivele dhe nën-nivele kuptimore. Manifestimi i kësaj formë poetike u bë i domosdoshëm për poetin, sepse shërbeu si mburojë kundër sulmeve ndaj ish-pushtetit serb në Kosovë. Pas pavarësisë së Kosovës, poezia e tij rifitoi lirizmin dhe ndjenjën poetike, por pa mundur të dalë krejtësisht nga stili i ngjeshur tradicional shqiptar. Tërë poetika dhe natyra e krijimtarisë së Podrimjes e bëjnë të denjë për të qëndruar nivelet e krahasimit me poetët që hodhën themelet e kulturës kombëtare, me ata që i dhanë jetë gjuhës, kulturës dhe kombit. Krahasimi i Podrimjes me kolosët e letërsisë kombëtare nuk mbetet vetëm në nivelin e poetikës, por më së shumti ai mbetet i krahasueshëm për nga temat dhe motivet tematike të poezisë së tij.

Mjeshtërinë poetike të Podrimes, lexuesi e ndjen në të gjitha veprat e tij poetike, ku më të spikatura janë poemthi *Hija e tokës*, në të cilën dallojmë një freski emocionale dhe vërtetësi komunikimi. *Hija e tokës* është një projektim i së ardhmes së ëndërruar dhe një shpalosje e të shkuarës së Kosovës ndër shekuj. E kaluar vjen që nga Antikiteti, lashtësia e fisit të poetit dhe e kombit. Antikja e fisit të poetit (Kosovës, trojeve shqiptare) është një mburojë e madhe historike para një invazioni të egër serb mbi Kosovën. *Hija e tokës* është dëshmi e madhe e mjeshtërisë poetike të poetit, të gjuhës ezopike dhe të lirikës patriotike të artikuluar përmes gjuhës së figurshme, kryesisht përmes simbolit, metaforës, paralelizmave dhe parabolave krahasuese

poetike. Censurimi i fjalës së lirë në Kosovë bëri që të kemi një përsosje të gjuhës figurative të poetëve për të mbijetuar nga ndëshkimet e sistemit të dyfishtë diktatorial (serb dhe komunist). Kjo e bëri Podrimen, ashtu si shumë autorë të tjerë, të arrijë kulmet e përsosjes gjuhësore dhe të figuracionit të thellë poetik. Poetika e Podrimes është në kërkim të vazhdueshëm të mundësive të reja dhe origjinale të shprehjes së emocionit, të imagjinatës dhe të filozofisë së jetës që vijnë dhe shfaqen përmes një simbolike të dendur në një cikël poezish: Guri, Kulla, Cungu, Poema e heshtjes, Kali i Trojës, Dëftore dhe Pylli. Simbolika e tyre na orienton drejt kulturës dhe historisë shqiptare. Simbolika e tyre është domethënie e pasurimit strukturor të këtyre leksemave, e një aktualizimi semantik të mbishtresëzimeve të tyre që nga kohët antike deri në kohët moderne. Simbolet e këtij ligjërimi mbeten në formën arketipore të kulturës kolektive, por edhe evropiane. Guri është shprehje e qëndresës që në kohët e lashta, është shprehje e autoktonisë në vendin e tij. Kulla është simboli i qëndresë përballë invazionit të vazhdueshëm, është simbolika e shpirtit të shqiptarit në viset e Kosovës, është djepi i lirisë dhe intimiteti të tij personal. Cungu simbol i cungimit të individit në një regjim diktatorial, shovenist, por edhe i mostjetërsimit edhe pse i cunguar. Heshtja simboli i censurimit dhe të një mënyre të mbijetesës. Heshtja është syri i fjetur me fyell në gojë, të cilit i cicërojnë zogjtë, ndaj ajo është më e vjetër se guri dhe më e fortë se vdekja. Poetika e Podrimes është strukturuar duke u mbështetur mbi metaforën, simbolin, por në fazën e tretë të krijimtarisë së tij kemi poetikë më të prerë, më të drejtpërdrejtë me një shkallëzim të ironisë deri në sarkazëm.²⁴

²⁴ Fitor Ollomani, Vështrim paronamik për letërsinë shqipe në Kosovë, Kukës, 2014.

Kreu III

3. Temat dhe motivet e Ali Podrimjes

Poetika e vargut të Ali Podrimjes, e çliruar nga konvencionalitetet tradicionale, është në shenjë e gjuhës dhe ekspresionit figurativ dhe në shenjë e një komunikimi të brendshëm dramatik. Fjala është për poetikën në kërkim të pandërprerë të mundësive të reja dhe origjinale drejt artikulimit të emocioneve, të imagjinatës dhe të filozofisë jetësore. Shtyllat paranjohëse të korpusit figurativ në poezinë e Ali Podrimjes, siç u përmend, janë Guri, Kulla, Mali, Muri, Ura. Poetika e Ali Podrimjes është e skalitur me dramatikën historike, nëpër stuhitë e së kaluarës dhe katarsisin e popullit, rrugë përmes së cilës artikullohet një unitet tërësor i ëndërrimeve dhe i idealeve të individit dhe kolektivit, të ndërgjegjes individuale dhe kolektive. Në krahët e një simbolike të tillë antike dhe mitike të fisit arbëror, Ali Podrimja do të realizojë vlera universale në strukturimin artistik. Pikërisht përmes depërtimit të ëndërrimit të tij emocional, si dhe animimit të frymës dhe shpirtit të fisit, Ali Podrimja realizon vlera gjithënjëzore. Cikli poetik “Pylli”, është një faqe e gjallë e udhëtimit poetik, me një hov donkishotesk nëpër universin e popullit të vet. Pylli, ky simbol i unitetit të botës dhe njerëzimit, është shkelur, është gërryer nga dhëmbi i ujkut. Përtej pyllit gjendet lumi, që e shuan etjen e tokës, etjen e të parëve, por që nëpër pyll të kalohet lirshëm dhe qetë duhet të të prijë Ylli, përkatësisht ideali, besimi i bartur në shpirtin popullor. I tërë cikli mbi Pyllin, paraqet një lloj mikrohistorie si një rrëfim i fuqishëm poetik nëpër të cilin ecet përmes metaforizimeve alegorike, përmes simboleve të qëndrueshme dhe aluzioneve që shpalosin njëkohësisht porositë e të parëve për të vërtetën e identitetit. Edhe poezia “Dëftore”, ndërlidhet me poemthin “Pylli” në rrafshin e së vërtetës së identitetit. Poeti Ali Podrimja edhe me këtë rast rrëfen përmes një narracioni të fuqishëm emotiv dhe impulsiv, për të njëjtën hordhi të pushtuesve të përbërë nga: perandorë, sulltanë, mbretër e carë që nuk prajtën së pushtuari tokën kosovare. Në porositë që rrezatojnë nga kjo poezi ndërlidhet bindshëm “Kënga e heshtjes”, e cila është po kështu artistikisht njëra nga më të realizuarat e Ali Podrimjes. Që në fillim të vargjeve të poemthit ndihet “pesha e heshtjes gjatë shekujve”. Megjithatë, poeti me këtë rast do të zbulojë edhe një faqe të ndritshme në këtë histori të heshtjes: është heshtja që nuk është e shurdhër! Përkundrazi, ajo gjallërohet si dhembje, si plagë e gjallë që ëndërron dhe beson në shërimin e vet. Ajo pra nuk është heshtje përfundimtare, se mbi të është Guri, pastaj është ngritur

Kulla, mandej Pylli – që të gjithë këto dëshmi që e kanë kohën e vet të palosur, të palosur të vërtetën e vet, dhembjen e vet. Heshtja kështu është syri i fjetur me fyellin në gojë, pranë këngës së zogjve. Dhe kështu mbillet edhe një variant metaforik për të sfiduar poetikisht kohën kolektive, vazhdimësinë ekzistenciale të qenies. Fjala është për dëshmi, për kërkim të pandërprerë të përsosjes së shprehjes poetike, dëshmi e fuqizimit të individualitetit poetik.²⁵ Po ashtu lexuesi në poezinë e Podrimjes gjen tema dhe motive tematike të botës shqiptare parë në dimensionin kohor dhe hapësinor, por nga ana tjetër gjen edhe tema dhe motive universale. Kosova është pika që bashkon çdo lexues në poezinë e Podrimjes, po ashtu raporti i babait me të birin, jeta në sinkroni etj. Nga tjetër, bota mitike e lashtësisë, gjeneza historike e kombit janë tema dhe motive që kërkojnë mund për të mbërritur në thellësitë e fjalës, mistikën e simbolikës dhe forcës semantike të shprehjes poetike. Studiuesi Roland Zisi, në librin *Letërsia bashkëkohore shqiptare* (poezia), merret me tematikën e poezisë së Podrimjes, me motivet e saj dhe poetikën. Për tematikën atdhetare: Në krijimtarinë e frymëzuar e të shkruar me këtë tematikë, poeti kombinon në një aksion të vetëm poetik një varg shenjash individuale, familjare, shoqërore, historike, gjeografike e kulturore të botës shqiptare, të cilat synojnë evokimin e etnisë dhe të atdheut.²⁶

Sipas konceptimit e klasifikimit të Ibrahim Rugovës mbi poezinë, poezia e Podrimjes është materia poetike që shtrihet sa në njërin tip të poezisë aq edhe në tjetrin. Ajo, në fillesat e saj shfaqet si poezi e entuziazmit me termin e pasqyrimin, kalon nëpër poezinë e lirizmit me termin e përjetimit dhe së fundi përfundon në poezinë objektive me termin e formësimit (natyrisht pasqyrimi i elementeve estetiko – poetike).²⁷

Në poezinë e Podrimjes jo vetëm që nuk mungon ndjenja e rebelimit, por ajo shfaqet në shumë raste e fortë dhe e artikuluar përmes disa tropeve gjuhësore të ndryshme, të sendërtuara te humori (i zi), satira, grotesku, ironia, fantastikja etj. Poezi me tipare të tilla i gjejmë në përmbledhjen poetike *Torzo, Pikë e zezë në blu, Sampo, Lum Lumi, Libri mbi të qenit, Te guri i Prevezës* etj. Ironia merr një peshë të madhe në shprehjen e asociacioneve të krijuara në poezinë e Podrimjes, ajo është përdorur si mjet shumë i fuqishëm në shprehjen e

²⁵ Ali Podrimja, *Vepra I*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 8.

²⁶ Roland Zisi, *Letërsi bashkëkohore shqiptare*, Tiranë 2008, fq. 201.

²⁷ Ibrahim Rugova, *Kritika*, Prishtinë, 2007, fq. 317.

temave, të motiveve tematike të ndryshme, në artikulin në formën më të plotë të kredos poetike.

Podrimja është poet i revoltës dhe i rezistencës, gjithnjë në luftë me të keqen, me mizorinë, barbarinë dhe më në fund në luftë me sëmundjen, vdekjen. Ai solli në poezinë moderne shqipe një ndjeshmëri dhe intonacion të ri poetik. Në veprat e tij poeti nuk shtron vetëm probleme të ekzistencës kombëtare, të etnisë dhe të atdheut, të realitetit të hidhur të kohës, po ai shtron probleme universale të ekzistencës njerëzore të rëndësishme në luftën e individit përballë sistemeve totalitare për liri dhe demokraci, të individit të mbërthyer me trauma e kriza gjithfarëshe, në kohën që karakterizohet si shekulli i qytetërimit teknik, po edhe i shkatërrimeve më të mëdha njerëzore, për të cilat dëshmon historia. Studiuesit e poezisë së tij theksojnë se ai nuk pushoi së shkruari edhe atëherë kur “kohë t’egra trokitën pullazeve tona gërmuqe” dhe kur “buzëqeshja u mbyll në kafaz”. “Dodona”, “Ura e Shenjtë”, “Molla e Kuqe”, “Guri i Prevezës”, “Janina”, “Tomori”, “Pashtriku”, “Korça”, “Ohria”, “Joni” etj., ishin toponime të shpeshta të poetikës së tij. Shkodra, Gjakova, Shkupi, Vlora, Kruja gjithashtu.²⁸

Poetika e Podrimjes mbart disa tipare që e bëjnë mozaikore dhe unike në tërë botën e letrave shqipe: në fillesat e saj nuk mungojnë diskursat narrative me nominacion fillestar të pranishëm, kurse në vijimësi ky nominacion shndërrohet në nominacion simbolik, ku mbizotërojnë konstruktet metaforike, metonimike dhe strukturimi i plotë i sistemit simbolik. Në kërkim të përsosjes së stilistikës dhe poetikës Podrimja krijoi sistemin e ligjërit eliptik në të gjitha rrafshet dhe njësitë gjuhësore. Tradita dhe letërsia epike folklorike patën një ndikim të fortë në poetikën e tij, ndaj vihen re elementet e rrëfimit epik elegjiak; po ashtu kënga dhe fyelli nuk mbetën jashtë sferës së ndikimit në poetikën e Podrimjes, ashtu si te D. Mehmeti kënga mbetet ngjallje e gjakut të arbit, të Kosovës dhe vargut të tyre. Në poezinë e tij, Podrimja, na shpie në traditën kombëtare dhe kulturore të popullit të vet - te gjëgjëzat, këngët legjendare, poezitë klasike shqipe duke i shndërruar ato në ligjërit bashkëkohore, të kuptueshme për njeriun e sotëm.²⁹

²⁸ Zymer Mehani, *Poezia e Ali Podrimjes*, 2019.

²⁹ Dorota Hrodyska, *E burkura fisnikëron të vërtetën*, Prishtinë, 1993, fq. 9.

3.1. Tematika e Podrimjes

Atdheu është një nga temat më të pranishme në poezinë e tij, atdheu i Podrimjes nuk ka shumë dallime nga ai i De Radës, Serembes, Skiroit, Asdrenit. Për Podrimjen atdheu nuk mund të kufizohet vetëm në marrëdhënien mes individit dhe vendit të lindjes, ai mbetet pjesë e shpirtit kolektiv të shqiptarit në të gjitha trojet. Podrimja, ashtu si Kuteli që sjell dramën e Kosovës në kohën e luftës, shfaqet në trojet shqiptare në tërë hapësirën e tyre duke na sjellë bukuritë dhe dramën e humbjes së tyre. Në hartën poetike të atdheut të Podrimjes nuk mungojnë as skajet e trojeve shqiptare në gjenezën e përmendjes së tyre. Shkëputja e disa trojeve të atdheut për Podrimjen përbën dramën më të madhe të kombit tonë, ndaj bukuritë e tyre nuk mund të mos jenë pjesë e mozaikut poetik të poezisë së tij, duke u bërë njësh me tokën mëmë. Ali Podrimja na sjell bukuritë dhe dhimbjet e jugut shqiptar, të Çamërisë. Në asnjë thërmijë, nuk u ndaka dot, poeti nga gjuha, pra nga Atdheu; poeti nga gëzimet dhe vuajtja, pra nga Atdheu; poeti nga gjaku i tij, pra nga Atdheu, poeti nga jeta dhe vdekja, pra nga Atdheu.³⁰ Kulla, guri, cungu, e shumë të tjera të cilat janë tipike për shqiptarët kanë marrë trajtën e gërshetimit në krijimtarinë e tij prej poeti. Poezitë e Podrimjes janë të mbështjella fort me metaforën, simbolin, dhe të disa prej figurave të tjera të cilat po ashtu lënë gjurmë mbi poetikën e tij.

Ali Podrimja shfaqet si një zë i pangatërrueshëm në poezinë shqiptare dhe flet në emër të Dhembjes tërësore pikërisht kur shumica e kolegëve të penës u thurin lavde arritjeve të komunizmit. Shqipëria e tij është e përjetshme, e shkëputur nga realiteti i çastit në disa shtresime kohore dhe hapësinore, të ndërthurura e të ndërvarura (Arbëria, Çamëria, Kosova, Shqipëria, Diaspora, Guri, Kulla, Uji i Madh, Drini, Sharri, Ereniku, Arta, Bjeshkët e Namuna, ura dhe lumenj dhe kulla dhe të vdekur të mbivendosur në kohë dhe në hapësirë etj, zonë në të cilën një vashë, bie fjala, mbytet në një lumë falë pikëllimit të brigjeve që nuk takohen), por e pacenuar dhe e paprekshme në poezi. Ajo është Uni-Versi***** i shpërbërë dhe i përbërë nga vers-e (vargje). Poetografia, - që t'i vëmë një emër gjeografisë së ngjizur nga Podrimja, - nuk është shprehja e një arratie në vargje, por e një angazhimi në fatin e amshuar të etnisë, ku përmasat e kohës janë të shkruara në një të tashme të paskajë. Poeti i këqyr vuajtjet dhe pamundësitë e dje-sot-nesër me syrin global dhe nuk i thërmon dramat e përditshme, apo të përjetshme, që të ushqejë globalizmin. Por është i vetëdijshëm se sa e tashme duhet të rrjedhë deri në

³⁰ Faruk Myrtaj, Kur atdheu mungon, prej Arbërisë në Çamëri, Albania, 2003, fq. 21.

(ri)përmbushjen e përfytyrimit të vet zanafillor, sa breza lipset të mbërrijnë në botën tjetër, mbase për ta ndrequr me çmimin e jetës baraspeshën e prishur të kohërave - dhe duron, por pa iu shmangur për as edhe një grimë tragjedisë së kombit të tij.³¹

Poetika e Podrimjes është në kërkim të vazhdueshëm të mundësive të reja dhe origjinale të shprehjes së emocionit, të imagjinatës dhe të filozofisë së jetës që vijnë dhe shfaqen përmes një simbolike të dendur në një cikël poezish: *Guri*, *Kulla*, *Cungu*, *Poema e heshtjes*, *Kali i Trojës*, *Dëftore* dhe *Pylli*. Titujt e cikleve poetike të mësipërme janë kryekëput simbolikë. Simbolika e tyre na orienton drejt kulturës dhe historisë shqiptare. Simbolika e tyre është domethënie e pasurimit strukturor të këtyre leksemave, e një aktualizimi semantik të mbishtresëzimeve të tyre që nga kohët antike deri në kohët moderne.

- Guri është shprehje e qëndresës që në kohët e lashta, është shprehje e autoktonisë në vendin e tij.
- Kulla është simboli i qëndresës përballë invazionit të vazhdueshëm, është simbolika e shpirtit të shqiptarit në viset e Kosovës, është djepi i lirisë dhe intimiteti të tij personal.
- Cungu, simbol i cungimit të individit në një regjim diktatorial, shovinist, por edhe i mostjetërsimit edhe pse i cunguar.
- Heshtja, simboli i censurimit dhe të një mënyre të mbijetesës. Marrëdhënia përcaktuese mes fjalës heshtje dhe fjalës poemë, bën që leksema “heshtje” të ketë një mbishtresëzim kuptimor tjetër antonimik, ku heshtja është një poemë, një rebelim i poetit. Heshtja është syri i fjetur me fyell në gojë, të cilit i cicërojnë zogjtë, ndaj ajo është më e vjetër se guri dhe më e fortë se vdekja.

Ali Podrimja është poet i kursyer. Poezinë e ka të ngjeshur e të lidhur në strukturë, kurse figuracionin konkret, shprehës e pa fjalomani prolikse artificiale. Çdo fjalë ka funksionin e vet. Çka e mahnit lexuesin shqiptar është mjeshtëria e lartë për të stolisur këtë peizazh shkëmbor të kursyer, që të kujton folklorin shqiptar, me metafora të pazakonta, struktura sintaksore të befta dhe rima të gjetura. Vepra e tij gurgullon nga metaforat. Dritëro Agolli (l.1931), ish-kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë në Tiranë, ka thënë: "Ali Podrimja i

³¹ Ardian – Christian Kycyku, U dynd dynjaja dhe gëlltitur mbet nga vargjet (Disa fjalë mbi praninë e Ali Podrimjes në poezinë evropiane), marrë nga internet në uebfaqen revistahaemus.blogspot.com

shpërndan metaforat, ashtu siç shpërndahen sheqeri dhe arrat në bakllava dhe nuk hidhen vetëm në një thellë të saj, pasi atëherë do të na velnin." Forma dhe struktura kanë vazhduar të evoluojnë në veprën e Ali Podrimjes, si në vëllimet *Zari*, Prishtinë 1990, dhe *Buzëqeshje në kafaz*, Tiranë 1993. Ai ka sjellë për herë të parë dhe ka trajtuar tema të reja, ndonëse brenda kontekstit të obsesionit të tij klasik e pa iu ndarë atij.³²

Sipas Konushevcit, krijuesit që kanë ndikuar në poezinë e Podrimjes, janë Migjeni e Mekuli, ndërkaq e krahason me simbolistin irlandez, Jejs. Ndërsa, kur shkruan për vëllimin poetik *Zari*, Konushevcit me të drejtë konkludon: ...poezia më e re e Ali Podrimjes është përsëri poezi e revoltës dhe e protestës së artikuluar fuqishëm kundër padrejtësisë jo vetëm sociale, por edhe njerëzore, në të cilën spikat angazhimi për t'u lakmuar intelektual, që e përshkon tërë librin. Megjithatë, marrë nga ta marrësh, lajtmotiv i poezisë së A. Podrimjes është dhe mbetet fati, ekzistenca kombëtare, madje edhe kur ligjëron për tema e motive, në të parë, të largëta,³³ përfundon Konushevcit. Vepra e Podrimjes, duke qenë në grupin e autorëve më të shquar të letërsisë shqiptare, përcjell gjithnjë mesazhe njerëzore, parime të një morali dhe marrëdhënieje të qytetëruar. Përmes një komunikimi origjinal, herë përmes humorit, herë përmes dëshpërimit njerëzor, herë përmes afirmimit të idealeve sociale, shkrimtari ynë ndërton një marrëdhënie krejt të veçantë me shqiptarët e tij, ku mbizotëron, nga njëra anë thjeshtësia, mënyra e drejtpërdrejtë e shprehjes, nga ana tjetër filozofia e thellë njerëzore mbi thelbin e jetës dhe të njeriut. Është pikërisht kjo filozofi e brendshme, që vjen thjesht e pa bujë, që depërton në shpirtin tonë.

Në lartësinë e vet artistike poezia e Ali Podrimjes shkëlqen misionare: poeti që nga fillimet ka gjakuar të jetë zë i dhembjes kolektive kosovare, vizion që mund të konsiderohet edhe si një ndërmarrje donkishoteske e llojit të vet, e zëri i tij poetik do të jetë thellësisht tronditës, i mprehtë, i qëndrueshëm, bartës i dhembjeve së të gjithëve. Prandaj poezia e tij, e përcaktuar, e lindur në valët e këtij shqetësimi dhe misioni nuk do të jetë në asnjë rrethanë një latent dëshpërues, i pashpresë i vuajtjes dhe dhimbjes, por përkundrazi, vargu i tij do të jetë mobilizues në drejtim të mbrojtjes së frymës, do të jetë një mburojë e shpirtit kolektiv gjatë vuajtjeve epokale të popullit të vet dhe poezi pa të cilën vuajtja dhe dhembja do të ishin tragjike, të pashpresa dhe absurde. Ali Podrimja si poet kërkon dhe zbulon sferat, shtyllat mbajtëse më vitale

³² Robert Elsie - Histori e Letërsisë Shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë & Pejë: Dukagjini 1997, fq. 311-312.

³³ Abdullah Konushevcit, Për Poezinë, Prishtinë, 1993.

brenda këtij oqeani vuajtjesh, duke shpalosur në artin e vet poetik burimet e shpresës dhe qëndresës.³⁴

3.2. Mitet kulturore që e drejtojnë poetin

Ali Podrimja, është, para se gjithash, poet i kujtesës, poet i kujtesës kombëtare. “Letërsia – thotë me të drejtë poeti – nuk mund të ndërrojë as të bëjë gjë pos të mbajë gjallë kujtesën...” Poezia e tij përtërin dhe shpalos toponiminë gati të harruar (Iliria, Morea, Janina, Nikopoli, Preveza), përkujton dhe ngjall figurat mitologjike ringjall historinë tonë të hershme dhe gojëdhënat e moçme. Në veprat e tij poetike të krijuara në trajtë mitesh, gojëdhënash apo legjendash, poeti vë dialog me historinë, mitologjinë. Ai është i vetëdijshëm se nuk bën të jetojë dhe të krijojë pa rrënjë, pa origjinë, pa të kaluarën. Poezia e Podrimjes në mënyrë sintetike dhe koncize shtron dhe kap problematikën e historisë së popullit shqiptar, problemet e identitetit të rrezikuar kombëtar. Vepra e tij poetike përbën një tërësi të përbërë, të ngjeshur, të kristalizuar, konsekuente dhe të saktë. Kjo është një poezi e një niveli të lartë artisti dhe e një dimensionit të jashtëzakonshëm etik, që ngërthen në vetvete respektin e thellë për njeriun e rëndomtë, për thjeshtësinë, guximin dhe nderin. Lidhjet e saj me nocionet themelore dhe elementare si dinjiteti e guximi njerëzor apo kërkesa e natyrshme e së bukures.³⁵

Mendimi mbi angazhimin përfshin natyrisht çështje të natyrës etike dhe morale. Ajo çka e shtyn mbi të gjitha fjalën e Podrimjes/poet është se ai e ka mjaft të qartë hapësirën imagjinare të krijesës poetike, që përkon kryesisht me etnosin e tij dhe angazhimi për këtë çështje nënkupton veprim dhe mendim. Ai e shtjellon mendimin para se gjithash në një kohë mitike, me vlera të padiskutueshme. Podrimja na ofron një model të qartë etik (Aristoteli) dhe po ashtu një model të qartë moral (Hegeli), i ndërgjegjshëm se njerëzit dështojnë nga ana morale, ndërsa institucionet nga ana etike. Poeti e vuan këtë krizë vlerash dhe shpesh i drejtohet hapësirave mitike. *Për shkak të dashurisë, për shkak të urrejtjes/baba im ka ngritur një kullë/Në majë të botës e ka ngritur/deri në tokë e kanë rrënuar zotat.*

³⁴ Ali Podrimja, Vepra 1, Akademia e Arteve dhe Shkencave të Kosovës, Prishtinë, 2013, fq. 8.

³⁵ Mazllum Saneja, Ali Podrimja – poet i kujtesës.

Koncepti i tij poetik lëviz dhe vendoset në vendin e shumë përvojave njerëzore. Të shumta janë mitet që hasim në poezinë e Podrimjes, por më të përdorurit janë: miti i flijimit (poeti Promete, Sizif) *hedh gurin në hapësi/Sizifi plak me mund* dhe miti i qëndresës *Kohëra e kohëra përgjak/ Dhe mund Sizifin plak*); *Tërë jetën çela varre/Dhe ngrita kulla/ Majë ëndrrash*.

Për Podrimjen poezia është *guri* i themelit në *Kullën* poetike të atdheut që ka ditur t'i mbijetojë historisë dhe kohës. Kjo nënkupton gjithashtu edhe vetëdijen e hidhur se lufta për mbijetesë nuk çon në proces ndërtimi dhe progresi, sepse siç na kujton Migjeni, *ku plogësi e ndërgjegjes gjallon, liria nuk asht!* Poezia e Podrimjes shpesh merr tone sarkazme kundër aftësisë së shqiptarit që nuk arrin të ndërtojë dhe të anashkalojë ndarjet, duke u lëkundur në politika përshtatjeje dhe statike, *si dele nuk dilet në pazar, apo na shurdhoftë i pagoji/me rrënjë ia shkullim/ e bëjmë gjumë të rehatshëm/mes gjinjve të një rospie*.

Siç na kujton Hysamedin Feraj: shprehja “kështu na erdhi historia” është përmbledhja e gjithë karakteristikave të tjera vetëkuptuese të shqiptarëve si popull: *i shpjegimit* ndaj ankesave pse jemi keq, *i legjitimit* të gjendjes pse jemi keq, *i krenarisë* se “kemi arritur të ruajmë ekzistencën”.

Podrimja, kur shprehet mbi dukuritë shoqërore, dëshmon përgjegjësi të madhe dhe ndjeshmëri të mprehtë; kujtesa e tij nuk është vetëm personale, por e ndërtuar nga një kujtesë historike në funksion të popullit, duke arkivuar data, emra, vende, ngjarje që kanë përshkuar dhe kanë ndikuar në procesin historik mbarëshqiptar.

Poezia e Podrimjes funksionon si mozaik gjeografik, në të cilin përveç referimeve të vendeve dhe të personazheve të Kosovës, gjejmë edhe vende dhe personazhe të tjera që kanë të bëjnë me Shqipërinë, Çamërinë dhe fshatrat arbëreshe. E ashtuquajtura *lirikë patriotike*, element karakterizues i shumë shkrimtarëve shqiptarë, tek Podrimja është e pranishme në mënyrë origjinale. Ali Podrimja na sjell bukuritë dhe dhimbjet e jugut shqiptar, të Çamërisë. *Në asnjë thërrmijë, nuk u ndaka dot*, poeti nga gjuha, pra nga Atdheu; poeti nga gëzimet dhe vuajtja, pra nga Atdheu; poeti nga gjaku i tij, pra nga Atdheu, poeti nga jeta dhe vdekja, pra nga Atdheu.³⁶

³⁶ Faruk Myrtaj, Kur atdheu mungon, prej Arbërisë në Çamëri, Tiranë, 2013, fq. 21.

Kritika e shoqërisë shqiptare, zhgënjimi dhe pikëllimi për qytetërimin “e cunguar” paraqiten nëpërmjet tablove poetike ku e shkuara dhe e tashmja ndërlidhen dhe vihen në dyshim në të njëjtën masë; një varg imazhesh izotopike lëvizin brenda kornizave të kësaj “fotografie të grisur” të hapësirës mbarëshqiptare: *gjymtimi yt pikëllon edhe në ëndërr*.

Të paraqitësh mirëfilltë marrëdhënien midis së shkuarës dhe së tashmes do të thotë të trajtosh konflikte të pashmangshme dhe si rrjedhim të jesh pre e kundërshtive të këndvështrimeve estetike dhe ideologjike. Ndoshta ka ardhur koha, siç sugjeron Paolo D’Angelo, ta braktisim idenë e artit larg jetës së përditshme, si përvojë e jashtëzakonshme dhe ta “... konsiderojmë si formë pasurimi, intensifikimi dhe zgjerimi të përvojës njerëzore...atëherë ndihet më pak nevoja për ta projektuar artin si përvojë e jashtëzakonshme larg nga e tashmja, në një të shkuar të largët apo në një të ardhme që akoma duhet të realizohet”.

Kjo marrëdhënie nënkupton edhe kthimin pas të disa zgjedhjeve poetike, si shprehje stilistike dhe formale, si strategji për të folur mbi botën që e rrethon dhe për të vendosur dhe përligjur rolin e tij si poet. Kjo shije paraprake ka të bëjë mbi të gjitha me evolucionin stilistik të Podrimjes, i cili, depërton në “arkivin mitologjik” të kulturës për të vënë në pah ato vlera që i mungojnë të tashmes. Nëse ky raport shihet si i pafrytshëm dhe dekadent kemi të bëjmë me një gjendje të ndenjur; nëse krahasimi me modelet e së kaluarës na lehtëson gjykimin kritik mbi realitetin tonë atëherë mund të flasim për lëvizje përpara: *Kohëve bredh dherave/në Kështjellë thonë zgjuar rri/unë besoj: Mbi kokë të Njeriut/Dritë bën ai*. (Skënderbeu). Sipas këtij pohimi, nuk janë aspak rastësore poezitë/poemat me temë historike ku konkretizohen zgjedhjet stilistike si pasqyrim i një bote autentike.

Marrëdhënia e poezisë së Podrimjes me mitologjiken dhe me folklorin në aspektin e shprehjes poetike, tradita letrare pararendëse dhe tradita letrare e krijuar, tradita mitologjike kombëtare e më gjerë, si dhe tradita folklorike kanë qenë një sistem referimi shumë i rëndësishëm në aspektin stilistik dhe formal. *Në poezinë e Podrimjes gjejmë të riaktualizuara dhe të risemantizuara një tërësi fjalësh të fondit mitologjik dhe folklorik, po ashtu gjejmë praninë palimpsestore edhe të strukturave të gatshme metaforike, që fillojnë nga tradita kombëtare folklorike, ndjekin atë mitologjike greke dhe duke mos mënjanuar*

edhe sistemin stilistik të kodimit poetik të biblës. Poezia e Podrimjes karakterizohet nga figura të konstruksionit e të diksionit dhe posaçërisht nga ato të dytat.³⁷

Në këtë pikë, edhe Basri Çapriqi tek *Simboli dhe rivalët e tij* thotë se: “Ndërmjet poezisë së deklaratës që ka përballë realitetin dhe poezisë së deklaratës që ka përballë historinë, poetët Azem Shkreli, Ali Podrimja, Rrahman Dedaj etj., kanë bërë kalimin e gjuhës në sferat e mitit letrar, të simbolit individual duke kthyer kështu artin letrar në natyrën e vet shumëdimensionale dhe polisemike. Kjo ka rëndësi parësore po të kemi parasysh zhvillimin e poezisë shqipe në Kosovë, si një poezi deklarative me tregues jo shumë të realitetit si ndodhte brenda kufirit shtetëror të Shqipërisë, por me referentë të fortë historikë që nga ana e vet kishin po ashtu, një ndikim të ngjashëm tkurrës, varfërues të artit poetik.”³⁸

³⁷ Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe*, Prishtinë, 1997, fq. 335.

³⁸ Ajlida Selimi, *Kodi dhe Diskursi Biblik në poezinë e Azem Shkrelit*, fq. 178, Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare të botuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Filologjisë dhe Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori – Filologji, Prishtinë, 18-30.08 2014.

Kreu IV

4. Ali Podrimja dhe revolta në vargun poetik për Kosovën

Podrimja cilësohej para se gjithash nga shpirti i pastër i revoltës dhe e ndjente mirëfilli përgjegjësinë dhe rolin e intelektualit përpara shndërrimeve të vullshme, por edhe delikate, të shoqërisë. Qysh në fillimet e tij krijuese ai iu përgjigj me refuzim dhe shpirt revolte pushtetit të padrejtësisë. Duke jetuar fazat e pasluftës së ish-Jugosllavisë (përfshirë krizën ideologjike) dhe ato që Kosova e tij kaloi për të mbërritur në statusin e saj të pavarur, Podrimja dëshmoi se cili duhet të ishte roli i njeriut të kulturës: *Në rrugën e verbër/rrri ndez vetëm/një llambë*. Poeti i mirënjohur, Ali Podrimja, me tokën, Kosovën ishte një dhe i pandarë. Aty gjeti motivet, frymëzimet, vrullin e jetës. Përmes shprehjes së dashurisë në vargje ndaj atdheut shprehu, thuaja haptas, edhe dashurinë ndaj lirisë që na mungonte. Poeti rritej dhe piquej në këtë atmosferë agonie, që e kishte mbërthyer Kosovën. Qyteti i Gjakovës, ku kishte lindur dhe shkollohej, qytet me traditë patriotike, ishte më i godituri nga policia serbe. Poeti i përfshirë në këtë përditshmëri ndjeu nevojë të rezistojë, të kundërvihet dhe ta stigmatizojë tërthorazi synimin e pushtuesit:

*Qaj rrafshi im i dashur, qaj
Diellin tënd verbuar e kanë tytat
E vatrën shkimbur deri më një.*

Vargjet janë shkëputur nga poemti lirik “Hija e Tokës” të cilin Ali Podrimja e shkroi në vitin 1960.

Ali Podrimja ishte i vetëdijshëm, si edhe shumë shkrimtarë të tjerë të mëdhenj shqiptarë, se ata në histori janë në rolin: atje ku shteret shpresa e popullit ta rikthejnë, atje ku këputet kënga e popullit ta vazhdojnë atë, atje ku të tjerët kanë kaptuar përpara, t’i mbërrijnë ata, gjithnjë me një hov dhe hapa më të mëdhenj nga ç’janë mundësitë e tyre. Dhe, në këtë kontekst është fare i veçantë dhe specifik raporti i poetit Ali Podrimja karshi Kosovës. Është me rëndësi historike thirrja që Ali Podrimja ua drejton kosovarëve të vet në këtë rrafsh të gjërave.

*“Zgjohu, Kosovë!
Zgjohu nëna ime e dashur,*

*balli im, emri im i shkelur,
zgjohu. A po e ndjen
vajin tim”?*

Me rëndësi është që në këtë dyzëshmëri të vërvitjes së tij poetike dhe zërit të tjetrit, të popullit të vet, të të zgjedhurve mes tij, Ali Podrimja gjurmon dhe është në kërkim të akordeve harmonike në kuadër të një polifonie, me çfarë ai vazhdon ta mbajë artin e vet poetik në majat e letërsisë shqiptare. Ai e lartëson në vete kullën e tij të brendshme, si simbol të qëndresës personale, që nuk është jashtë figurshmërisë kolektive për kullën e qëndresës. Përqendrimi për prestigj në universin e tij krijues mbetet optimal, absolut, kur thellohet shtresimeve arketype të identitetit arbëresh, shenjëzuar nëpër kodet semantike të gjuhës së pazbuluar, të gjuhës së frymës dhe shpirtit kolektiv. Në ato momente para horizontit të poetit shfaqen dhe më pas hapen portat qiellore, para së cilave vjen me porositë e gjetura kristalisht të qarta arbërore, mbërrin në botën të cilën e artikulojnë fjalët e vërteta poetike.³⁹

Podrimja përmes poezisë denoncon me zemërim indiferencën e Evropës që nuk ndërhyr për të zgjidhur gjendjen e rëndë në Kosovë: *Pa frikë se e godas ma pret udhën Dhelpira/Bie në gjunjë/Dhe e kafshoj trishtimin në ballë*. Shpresa lëkundet mes kontrastesh të dhimbshme. Poeti pret që të lindin ndërtuesit e të ardhmes dhe më një buzëqeshje shkatërroj fytyrën e të Plotfuqishmit. Ai dyshon se ky shpërthim zemërimi ndoshta nuk përputhet me idealet e së bukurës ashtu siç duhet, prandaj i drejtohet vogëlushit të tij, duke i kërkuar falje, por kohë të egra trokasit pullazeve tona gërmuqe dhe tanke të armatosura shpërndajnë lodrat e fëmijëve. Pra, kohë absurde:

*Ja dita plot tërmete vogëlushi im
Kur do të mësosh
Se njeriu është kafshë e bukur
Dhe kur fatin tënd në qiell e vizatoj me thonj*

Qenësorja është: mbijetesë e poezisë si dëshmi dhe frymëmarrje artistike, krijesë që i kushtohet njeriut të Podrimjes dhe njerëzimit në përgjithësi: *Nuk vdes Kosova*, pohon ai, *vetëm*

³⁹ Ali Podrimja Vepra, Botimi i parë, Akademia e Arteve dhe Shkencave të Kosovës, Prishtinë 2013, fq. 7.

njerëzit transformohen në rrënjë dhe degë të një pemë, ku Djalli (do të ngjitet) dhe do të bjerë, përgjithmonë atëherë poeti do të qajë, por nga gëzimi, si burrat e vërtetë të tokës së tij.

Për këta njerëz dhe për vendin e tyre ia vlen të thuhet fjalë, të krijohen poezi me besim të thellë: *edhe pas një mijë vjetësh/do t'i them të njëjtat fjalë*. Besimi i Podrimjes nuk dëshmohet vetëm mbi letër. I përcaktuar të njësohet me fatin e Kosovës e me një *këmishë të gjakosur*, të shëtiste rrugëve të Evropës, duke denoncuar gjendjen e rëndë të dhunimit të të drejtave të njeriut, po njëherazi dëshmon qëndresën e popullit të vet në sytë e botës, edhe pse shqiptarët modernë me *buzëqeshjen e ngrirë* dhe me dukurinë shoqërore të emigrimit u duken të tjerëve si relikte që tronditin qytetërimin.⁴⁰

Podrimja dhe poezia e tij janë urë lidhëse drejt ëndrrës për liri dhe jetës së denjë. Diçka mbetet pezull, ose ëndërr e parrealizuar, ndaj ura qëndron, *me një krah në qiell me tjetrin në mishin tim*.

Ali Podrimja ishte poet autentik, që kishte lexuar shumë, por nuk imitonte askënd, ishte Sovran, prandaj edhe me sukses solli risi në artin e vargimit, veçmas vargun e lirë podrimian:

“Për shkak të dashurisë, për shkak të urrejtjes

Baba im ka ngritur një kullë.

Në maje të botës e ka ngritur,

deri në tokë e kanë rrënuar zotrat.

Motra ime vëllai im kurban janë bërë.

Baba im atëherë perëndi ka sharë.

Gurin e rëndë në themel e ka vënë,

në shtatë konaqe muratorë ka kërkuar.

Sa më lart kullën e ka ngritur,

aq më të fortë veten e ka ndier. (Kulla, f.17.)

Dashuria dhe shqetësimi, te poeti ishin mjaft të ndjeshme, thuajse gjithkund të pranishme, por nuk viheshin në një paralele.

⁴⁰ Griselda Doka – Realiteti jetësor në poezinë e Ali Podrimjes

Këto pak vargje që i shkëputa dëshmojnë bindshëm mbi strukturën e vargjeve, pa rimë e metrikë, por me kuptim të plot të mendësisë shqiptare. Këtu e hasim metaforën dhe aliteracionin që poezisë i bëjnë mbështjellje të mirë meditative.

Gërshetohen natyrshëm edhe elemente të letërsisë popullore ...motra ime vëllau im kurban janë bërë në shtatë konaqe... etj. Fjala e zgjedhur shtrihet lirshëm në varg dhe në strofë, ku merr peshë rrëfimi poetik dhe peshë krijimi artistik. Ali Podrimja është krijues i frymëzuar që magjeps e qëndron në miqësi të përhershme me lexuesit. Këtu vetëm maniaku Qosja theu dhëmbët e kalbur, ku e ngarkoi veten haptas me injorancë kryeneçe.

“Brenda koncizitetit poezia e Ali Podrimjes, ka aliteracione dhe ndonjëherë papritur edhe rima e asonanca, megjithatë të rralla, pasi në përgjithësi vargu i tij është i lirë” - Dritëro Agolli, f. 10-11.

Ali Podrimja kohën e trajton artistikisht në tre vizione: e djeshmja, e sotmja dhe e nesërmja. Të djeshmen e hidhur, të tashmen plot trazira dhe të nesërmen për një shpresë më të mirë.

Rima te poezitë e Ali Podrimjes, megjithatë ekziston dhe atë kumbueshëm, të shumtën në mes të vargut. Thënie poetike, metaforë me kuptim të thukët: “Secili i falem nga Diçka, kush emrin, kush eshtrat la” (Rozofati) f.19.

Te poeti i spikatur, Ali Podrimja hasim edhe një element shumë të vlershëm, që ngrit artin poetik të tij në kupolën poetike.

Poezia e tij në shumë raste merret si sentencë apo filozofi poetike: - A mundet dy bineq të rritën në një djep bashkë/ njëri të pijë qumshtë/ e tjetri binak të pijë gjak.

Ose,

... Miq,

Kosova është gjaku im që nuk falet - që mund të merret edhe si program patriotiko-politik. Duket se pesha e rëndë e fatit të Kosovës, e gjithë shqiptarisë është bërë barrë e epërme në poezinë e Podrimjes, por jo makth, por as ndjesi që kalon pa u lënduar, pa u prekur. Megjithatë poeti i përulet atij dëshirimi metaforik me ndjesi të mirë, pasi kalon nga dhembja

njëherë ku guri pikon gjak dhe mandej uron për fuqinë që i fal.⁴¹ Ku guri pikon gjak dhe ti uron për fuqinë që ta fal, është një përjetim ndoshta nga më surrealët, nga ata që të rrëqethin mishtë. Prekja e poetit bëhet dhimbja jote. Kemi këtu një nga ato poetikat që kanë krijuar simbiozën e bashkëvuajtjes së individit sikur kombi i tij vuan. Jemi këtu mëdyshas në hapësirën frymore të lejuar për poetin dhe krijimin dhe rezonancën ose më saktë hapësirën frymore të lejuar për lexuesin dhe ndjesitë e tij. Vargu i Podrimjes kullon si një bashkëbisedim që nuk t'i rronit veshët, por e tërheq edhe shpirtin edhe zemrën të dëgjojë.

4.1. E bukura si kërkim e mbijetesë

Qysh në fillimet e tij krijuese poetike Podrimja dëshmon se pavarësisht mizorive, do të ndjekë të bukurën e jetës, e cila përfytyrohet si ideal. Metaforikisht sytë e tij bëhen *fole të pëllumbave të bardhë*, dhe *Gëzimi puth gëzimin/E fuqia e vdekun shkrihet n'kangë*. Qëllimi i artit është mbijetesa mbi heshtjen/vdekje, sepse *Në jetë dashunojmë, o njerëz/Vetëm me mundë urrejtjen/Vetëm me harrue vdekjen*.

Ajo çka nuk lejohet në poezinë e Podrimjes është gjendja statike e rrjedhës së jetës. Edhe kur shkretëtira ka mbërthyer tokën e tij dhe poeti që shikon gjithçka me *sy të përgjakur* vendos të reagojë dhe *kafshon heshtjen derisa ta vdesë*, pra ta bërë poezinë e tij të flasë.

*Rreth trupit tënd si gjarpër mbështjell jam,
Vatrat e shkrimbura për t'i përflakur,
Duar e këmbë t'i lidh me lëmshin e përrallave të tua.*

Poeti shpreh në mënyrë të drejtpërdrejtë dashurinë e përjetshme për tokën e tij deri në sublimim, sepse dashuria fiton (duhet të fitojë!) mbi gjithçka: *në grykë të shkëmbit/të gurëzohem*, apo *Edhe i mbrami gur i kullës/ po të rrëzohet/unë do të dua*.

Kur intelektual/poet percepton katastrofën individuale dhe kolektive, lufta e tij zhvillohet në fushën e artit, ku me fuqinë e iluzionit dëshmon ekzistencën e atij që akoma nuk është mundur nga vdekja, Poeti: *hedh gurin në hapësi/ Sizifi plak me mund - Kohëra e kohëra përgjak/dhe mund Sizifin plak*.

⁴¹ Dhurata Hamzai, Poezia e Podrimjes, Shqisa dëshmitare, botuar në Revistën shkencore Haemus, Tiranë, 2004.

Në planin artistik vuajtja ka të bëjë me ndjenjën e mosrealizimit e moskompletimit të asaj që poeti prej kohësh e kërkon: ndoshta një model njerëzor që të arrijë të vërtetën e amshuar ose plotësimin dhe përmirësimin e botës njerëzore. Në këtë kërkim të vazhdueshëm, *udhëtimi* i poetit ndërpritet shpesh, herë nga figura e dykuptimtë e *maces së zezë*, herë nga hije, qenë apo vetë ai. Vetëdija e mprehtë e poetit që njeh dobësinë e njeriut, shkëlqen aty ku duhet t'i japë rëndësi njerëzores si vlerë: *nëse s'flas/jeta ime s'ka qetësi/fjala ime bëhu Unë dhe Plaga ime/le të marrë /frymë thellë*. Vlera e njeriut, pra, matet nga aftësia e flijimit për tjetrin, ku “fjala *Unë* do të thotë ja ku jam. Të bësh diçka për tjetrin. Të dhurosh. Të jesh shpirt njerëzor, këtë do të thotë”.

Arti i Podrimjes ka të bëjë para se gjithash me dhimbjen, por edhe dëshirën e të qenit i pranishëm në të tashmen, ku mësimi më i rëndësishëm njerëzor është:

*Ti mëso te duash vogëlush. Ti mëso të ecësh
me këmbët e tua
mbi të keqen mbi të mirën, mendo me kokën tënde
kurrë mos pështyj në dashuri, as në pleh;
Mallkim i fisit*

Dashuria si vlerë është në të njëjtën kohë bredhje e njeriut brenda dyshimeve dhe zhgënjimeve. Ku *notuesit*-luftuesit e jetës enden vazhdimisht të kërkojnë *bregun*. E kuptueshme është, pra, shpëputja nga realiteti i cili nënkupton mbijetesën e dobët. Për poetin ky qëndrim është i papranueshëm:

*Ai nuk jam Unë
Ai nuk je TI
Kush jam, kush je?
Syri yt mbyllet, dhe frëngjia në Kullë.
Poezia më e bukur ende s'është shkruar
as do të shkruhet
përderisa zhytësit ende jetojnë
.....
për inat këtë ditë ta sosim deri në fund.*

Edhe pse i tronditur, Podrimja gjen forcën ta sublimojë dhimbjen në poezi duke e parë si pjesë të jetës me të cilën duhet të mësohemi të bashkëjetojmë, së këndejmi në planin real poeti sugjeron se mund t’ia dalim kësaj dhe ta pranojmë vdekjen si pjesë të jetës: *unë megjithatë deri në vdekje/do ta kërkoj atë që e humb.*

Provat e kësaj qëndrese Podrimja i dha mirëfilli në veprën “Lum lumi”, që është testamenti poetik i një babai që e përballon humbjen e të birit; dëshmon se dhimbja personale shndërrohet në dhimbje universale; Lumi i tij bëhet bir/vëlla/burrë i të gjithëve. Këtë dhimbje Podrimja e përshkon me qëndresën dhe këmbëngul në të drejtën morale, ligjore dhe ndërkombëtare për t’i luftuar padrejtësitë: *Dhimbja ime/ ka dy sy, dy vesh një hundë.*

Për një poet të angazhuar dhe kritik të realitetit, padrejtësitë e kanë një burim dhe marrin shkas nga ndonjë situatë e caktuar. Kjo ngjet në shoqërinë moderne, ku njeriu është i kapur në “grackën” e zhvillimit dhe vetëmjaftueshmërisë, ndrydhje dhe vetëmjaftueshmëri që na ka çuar në indiferencë. Poeti nuk e ngujon fjalën; shoqëria e përparuar ngjall neveri tek ai. Nën urdhrat poetike të zemërimit të Podrimjes digjet qyteti (Parisi-moderniteti):

mbyllja sytë hundët veshët shtrëngoja dhëmbët

bërtisja në ankth

ç’ëndërroje vallë

athua ëndrra jote i ngjante ëndrrës sime

a ishte e Bardhë zot a kishte diçka të Kosovës

Qyteti digjet edhe:

në fytyrën time të verdhë të përgjumur pështyja

vizatoja fytyrën e vendlindjes

shkelja hijen time të shalakatur

digjet qyteti edhe kur ligji i jetës është i pamëshirshëm:

në ashtin tënd më thellë ishte dhimbja jote shëtitëse

Për këtë shoqërie duket se i vetmi produkt është “tjetërsimi i njeriut” të cilit Podrimja i kundërvihet me shpirt revolucionar.

Mësoj veshin me vetminë e fjalëve e shkronjave

Me shushurimën e ujërave

Dhe shpirtrave të fikur

Këtu çdo gjë miku im paguhet me kokë

Edhe pse në kulmin e dhimbjes, poeti beson në jetë dhe në bukurinë e saj.

po ç'bukuri është ajo lum vogëlushi

kur edhe nuk vyshket

Podrimja përmes poezisë denoncon me zemërim indiferencën e Evropës që nuk ndërhyr për të zgjidhur gjendjen e rëndë në Kosovë: *Pa frikë se e godas ma pret udhën Dhelpra/Bie në gjunjë/Dhe e kafshoj trishtimin në ballë*. Shpresa lëkundet mes kontrastesh të dhimbshme. Poeti pret që të lindin ndërtuesit e të ardhmes dhe më një buzëqeshje shkatërroj fytyrën e të *Plotfuqishmit*. Ai dyshon se ky shpërthim zemërimi ndoshta nuk përputhet me idealet e së bukurës ashtu siç duhet, prandaj i drejtohet *vogëlushit të tij*, duke i kërkuar falje, por *kohë të egra trokasit pullazeve tona gërmuqe dhe tanke të armatosura shpërndajnë lodrat e fëmijëve*. Pra, kohë absurde:

Ja dita plot tërmete vogëlushi im

Kur do të mësoh

Se njeriu është kafshë e bukur

Dhe kur fatin tënd në qiell e vizatoj me thonj

Qenësorja është: mbijetesa e poezisë si dëshmi dhe frymëmarrje artistike, krijesë që i kushtohet njeriut të Podrimjes dhe njerëzimit në përgjithësi: *Nuk vdes Kosova*, pohon ai, *vetëm njerëzit transformohen në rrënjë dhe degë të një pemë, ku Djalli (do të ngjitet) dhe do të bjerë, përgjithmonë atëherë poeti do të qajë, por nga gëzimi*, si burrat e vërtetë të tokës së tij.

Për këta njerëz dhe për vendin e tyre ia vlen të thuhet fjalë, të krijohen poezi me besim të thellë: *edhe pas një mijë vjetësh/do t'i them të njëjtat fjalë*. Besimi i Podrimjes nuk dëshmohej vetëm mbi letër. I përcaktuar të njësohet me fatin e Kosovës e me një *këmishë të gjakosur*, të shëtiste rrugëve të Evropës, duke denoncuar gjendjen e rëndë të dhunimit të të drejtave të njeriut, po njëherazi dëshmon qëndresën e popullit të vet në sytë e botës, edhe pse shqiptarët modernë me *buzëqeshjen e ngrirë* dhe me dukurinë shoqërore të emigrimit u duken të tjerëve si relikte që tronditin qytetërimin.

Podrimja dhe poezia e tij janë urë lidhëse drejt ëndrrës për liri dhe jetës së denjë. Diçka mbetet pezull, ose ëndërr e parrealizuar, ndaj ura qëndron, *me një krah në qiell me tjetrin në mishin tim*. Te faqja 16, atje ku Namiku e ka shpjeguar, pse e ndien veten borxhli ndaj asaj që Ali Podrimja ka shkruar për Çamërinë, unë kam thënë: “Ti ke bërë shumë mirë që e ke ndier veten borxhli ndaj poetit gjakovar, por duhet të dish që edhe ai është ndier gjithë jetën borxhli, midis tjerash, edhe ndaj Çamërisë”. Do të quhej i paformuar një poet shqiptar, i cili nuk do të kujtohej që ka Shqipëria edhe një Çamëri, edhe një Konicë, edhe një Kostur.⁴²

Në fillim të librit, mu poshtë titullit, kam shënuar: “Unë nuk e di a ka ndonjë poet tjetër shqiptar nga Shkodra, nga Korça apo nga Gjakova, që t’i jetë qasur me kaq përkushtim, sa Ali Podrimja, temës së përbashkësisë sonë kombëtare, duke përfshirë aty, krejt natyrshëm, edhe Çamërinë”. Kaq mjafton. Ai që e ka përjetuar ç’ka shkruar Ali Podrimja për Metohinë, d.m.th, për Rrafshin e Dukagjinit, e kupton dhe e përjeton edhe “Gurin e tij të Prevezës”.⁴³

4.2. Podrimja dhe emblema hamletiane

Modelet e heronjve të paraqitur nga Podrimja janë të shumtë, por ai që më duket se e përmbledh idenë e poetit është Hamleti. Poezitë, të cilat i referohen drejtpërdrejt kësaj figure, janë “Vetëm ose hamlet i sëmurë”, “Kohë dhelprash” dhe “Bota tepër e vogël për shpirtin tënd”. Në to vihet re dyshimi ekzistencial që identifikohet me hamletin, me “h” të vogël, në një kohë

⁴² Namik Selmani, Borxhi i Ali Podrimjes, Poezi të zgjedhura, Tiranë, 2015, fq. 16.

⁴³ Namik Selmani, Borxhi i Ali Podrimjes, Poezi të zgjedhura, Tiranë, 2015, fq. 4.

dyshuese e kohë dhelprash. Podrimja i vuajtur dhe i vetmuar shfryhet. Në këto vargje shprehet imazhi i botës së sëmure dhe të korruptuar, ku jeta dhe veprimet e humbasin vlerën.

Figura e Hamletit është një emblemë që na kujton se njerëzorja nuk na është dhënë si garanci, por si një proces që duhet pushtuar, fituar e merituar. Njerëzorja ka nevojë edhe për heronj e të jesh hero do të thotë të jesh bir i dhimbjes.

Vlera e një hero i a nuk matet pikërisht aty ku s'ka hapësirë veprimi dhe mendimi të lirë? *But I have that within which passes show/these but the trappings and the suits of woe* (Ham. I, II:85)

Podrimja këtë e dinte mirëfilli dhe ngadhënjën mbi frikën përmes shprehjes poetike, *s'mundem më tepër se sa të të jap emër*.

Në të vërtetë, njeriu s'ka alternativë midis jetës dhe vdekjes, por mishëron mundësinë e të qenit *Njeri-si-proçes*, ku dallimin e bën konflikti i zgjedhjeve të përditshmërisë, që na ndihmojnë të ndriçojmë botën që na rrethon, *njeri apo djall, do të lindë sonte nata?* Konflikti midis veprimit dhe mendimit (L.S. Vygotskij 1972) lëkundet në një hapësirë që kërkon drejtpeshim të vazhdueshëm.

Podrimja, ashtu si Hamleti, ruan dhe kultivon ideale utopike, të cilat dhuna dhe arroganca e realitetit i vënë seriozisht në sprovë. Ai përdor shpesh ironinë, si mjet shpëtimi, sepse njeriu/poet kujton se është i lirë të programojë, por në të vërtetë nuk e di se çfarë mund t'i ndodhë dhe çfarë mund të korrë nga veprimet e tij: *The dram of evil/doth all the noble substance often dout/to his own scandal* (Ham. I, IV: 35)

Podrimja flet dhe denoncon padrejtësitë dhe dhunën, por është i vetëdijshëm se s'mund të shkojë më tej. Sovraniteti i tij si poet është i ligjshëm brenda kufijve të ekzegjezës letrare. Si Hamleti, ai e parandien të keqen që e kërcënon shoqërinë, madje në faza të ndryshme zemërimi dhe rebelimi i tij shpërthejnë kundër situatave dhe personave konkretë. Pra, hero i vërtetë është ai që di të heqë dorë nga alternativa që mund ta largojnë nga qëllimi dhe projekti i tij, që provon turp dhe ndërron ide; iluzionet e tij mund të kthehen në zhgënjime të padurueshme. Ky lloj hero i është i pranishëm në procesin historik, por nuk e zotëron atë dhe as nuk tërhiqet zvarrë prej tij. Rrethanat nuk e përmbysin asnjëherë vetëdijen e heroit. Si Hamletit që i duhej drama për të zënë

në kurth *ndërgjegjen e mbretit*, Podrimja në fund të fundit këtë ka synuar në poezinë e tij *zgjimin e vetëdijes* së njeriut. Bota nuk ndryshon me jetën apo vdekjen e një poeti, por fuqia e fjalës vepron kur zgjohemi dhe ndjejmë dridhmën e rebelimit kundër padrejtësive. Aftësia krijuese e heroit/poet mundëson t'i kundërvihemi realitetit të tillë, për të krijuar hapësira imagjinare të strehimit e të mbijetimit shpirtëror.

Kreu V

5. Të tjerët për Ali Podrimjen – kritika

Poezia e Podrimjes shënoi jo vetëm arritje në letërsinë shqipe, por ato tërhoqën edhe kritikën letrare karshi risive letrare, tematike dhe ideore si të një triptiku me harmoni të plotë të qenies në një të vetme dhe të papërsëritshme të poezisë së Podrimjes në letërsinë shqipe. Poezia e tij u bë manifesti kryesor i modernes në poezinë shqipe, u bë këngë e shqipes në tërë arealin e letërsisë botërore, në jetësimin e këtyre vlerave luajti një rol të veçantë kritika letrare. Për veprën e Podrimjes kanë shkruar emra të njohur të botës së artit poetik e të kritikës si: Hasan Mekuli, Vehap Shita, Ali Aliu, Rexhep Qosja, Rexhep Ismajli, Bashkim Kuçuku, Xhezair Abazi, Gani Bobi, Mensur Raifi, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Basri Çapriqi, Hysni Hoxha, Agim Vinca, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Anton Berisha, Sali Bashota, Visar Zhyti, Faruk Myrtaj, Milazim Krasniqi, Vehbi Bala, Perikli Jorgoni, Abdulla Konushevc, Rahman Paçarizi, Jusuf Buxhovi, Ali D. Jasiqi, Shefqet Riza, Asllan Selmani, Ismail Syla, Robert Elsie, Mazllum Senaja, Dorota Horodyska etj.

Ali Podrimja sipas kritikës letrare shqipe konsiderohet poeti më i madh bashkëkohës shqiptar në hapësirën gjuhësore shqiptare. Autor i më se tridhjetë librave me poezi dhe eseistikë, krahas Ismail Kadaresë është shkrimtari më i përkthyer shqiptar në gjuhë të botës si në anglisht, gjermanisht, italisht, frëngjisht, suedisht, polonisht, hungarisht, sllovenisht etj.⁴⁴ Sipas përkthyesit të letërsisë gjermane Hans-Joachim Lanksch edhe në vendet perëndimore si në Gjermani ashtu dhe në Austri, poeti Ali Podrimja vlerësohej lart nga kritika letrare. Më me rëndësi, ndoshta, është jehona te publiku. Aliu kishte shumë orë letrare para publikut gjerman dhe austriak, sidomos në vitet e '90, ku dëgjuesit ishin thjesht të entuziazmuar nga niveli, bukuria dhe ekspresiviteti i poezisë së tij. Publiku ka qenë mirënjohës Aliut edhe për shkak se ai dëshmonte që shqiptarët e Kosovës nuk janë vetëm një masë refugjatësh të mjerë, por një popull me kulturë të lartë në nivel evropian. Sipas përkthyesit Hans – Joachim Lanch çdo përkthim i çdo poeti të vërtetë është i vështirë. Vështirësia specifike e poezisë së Aliut qëndron te dendësimi i saj ku çdo rrokje ka peshën e saj të domosdoshme, vlerën e saj estetike dhe funksionin e saj

⁴⁴ Mazllum Saneja, Ali Podrimja – poet i kujtesës.

semantik kështu që dhe përkthyesi duhet t' i kursejë rrokjet, kurse gjermanishtja ka shumë rrokje pa domethënie, që kanë vetëm ndonjë funksion gramatikor, si p.sh. "ich habe ihn gesehen" (shtatë rrokje)" – "e kam parë" (tri rrokje). Përveç kësaj, gjuha poetike e Aliut shquhet nga një frazeologji e pasur. Fjalët gjinden në fjalorë, ndërsa frazeologjizma – kombinime specifike fjalësh – nuk gjinden në fjalorë.⁴⁵ Bota artistike e Ali Podrimjes është e njohur edhe për adhuruesit e poezisë edhe në Greqi me botimin e përmbledhjes "Harta e grisur", e cila është përkthyer nga Iljaz Bobaj. Kjo përmbledhje pak më vonë kishte fituar shpërblimin e lidhjes së shkrimtarëve grekë "Kafeneja e ideve", udhëhequr nga kritiku, romancieri e eseisti i mirënjohur Dino Kubati. Përmes studimit të studiueses së letërsisë Griselda Doka në analizën e saj të titulluar "Rreth poezive të përkthyer italisht të Azem Shkrelit dhe Ali Podrimjes" kuptojmë se poezitë e Ali Podrimjes janë përkthyer në italisht qysh nga viti 1963 dhe Ali Podrimja cilësohet si paraprirës i ideve perëndimore në poezinë shqipe të Kosovës.⁴⁶

Po ashtu poezia e Ali Podrimjes ishte objekt studimi i mikut të shqiptarëve Rober Elsie albanologut, shkrimtarit dhe përkthyesit që i dha jetë kulturës shqiptare nëpër botë, i cili ka botuar gjithashtu përkthime letrare në anglisht dhe gjermanisht, veprën e poetit kosovar Ali Podrimja (l. 1942) në *Who Will Slay the Wolf: Selected Poetry* (Kush do të vrasë ujkun: poezi të zgjedhur), Nju Jork 2000.⁴⁷ Rrallëherë ndonjë fjali më ka ardhur njëherazi në të dyja gjuhët që shkruaj. Fjalja *U dynd vdekja në kullën e Poetit dhe i rrëmbëu fëmijën* (në shqip) dhe *Năvăli Moartea în turnul Poetului și-i răpi copilul* (rumanisht) më është ngulitur në mendje pas leximit të poezisë së Ali Podrimjes**, përkthyer në rumanisht. Ndodhia që ka lindur fjalinë e mësipërme është aq e dhimbshme, saqë lyp heshtjen e një përshpirtjeje, e ruajtjes së diçkaje të shenjtë, por e njëjta heshtje ta përshfaq vegueshëm shtjellimin dhe çnjëtimin e një të shkruari që vështirë se mund të ndryhet në kanune a rryma letrare. U dynd vdekja në kullën e Poetit dhe i rrëmbëu fëmijën. Djalë. Mbartësin e gjakut, e emrit dhe të ardhmes së fisit. Në vitin sprovëmadh 1982. I la në këmbim penën, trandjen e prindit mbetur pa bir, - si në kohëra lufte, kur jo fëmijët varrosin prindërit, por anasjelltas, - si dhe një sasi të stërmadhe letre të bardhë. Në atë letër dergjet i vetmi ngushëllim, i shkallëzuar, gati-gati ritual, i Prindit-Poet. Mirëpo i rrëmbëu djalë. Mirëpo i la krejt pjesën tjetër të botës. Biri merr me vete një botë të tërë, ndërsa Prindit i duhet të rindërtojë

⁴⁵ Marrë nga <https://albertvataj.blogspot.com/2012/07/perkthyesi-hans-joachim-lanksch-thjesht.html>, Përkthyesi Hans Joachim Lankch – Thjesht u dashurova me poezinë e Ali Podrimjes

⁴⁶ Griselda Doka, Rreth poezive të përkthyer italisht të Azem Shkrelit dhe Ali Podrimjes, fq. 4

⁴⁷ Anisa Demiraj: Përkushtimi i Robert Elsie's për Shqiptarët, i botuar në Revistën Shkencore - Pashtriku.Org

nga shkretia e strukur përtej letrës së bardhë dhe jetës së nxirë dhunshëm botën-me-djalë. Aspak rastësisht, biri quhet Lumi***. Barasvlerësi i Përmbytjes dhe i ujit të së shtunës në traditën shqiptare është E mori lumi. Ky lumë haset edhe në përfytyrimin apokaliptik të prozatorit të madh Mitrush Kuteli. Lumi i Madh përmbys gjithçka, kthen së prapthi, rrënon dhe gëlltit një botë të tërë - ndërsa prindi Ali Podrimja lipset ta mposhtë letrën e bardhë të një zije pa ngushëllim duke pritur (edhe ne tok me të) çfarë ka për të sjellë Lumi i Vogël.⁴⁸

Andaj në vijim po paraqesim mendimet dhe kritikën e studiuesve të tjerë shqiptarë dhe të huaj të letërsisë shqipe për poetin Ali Podrimja:

Dritëro Agolli

Ali Podrimja është i njohur për lakonizmin poetik, për kursimin e fjalës... prirja e Ali Podrimjes në poezi është drejt meditimit... Duke medituar, ai nuk e sodit objektin, por hyn në brendësinë e tij, për të gjetur dramën. Një poet me vështrim të tillë është i prirur për të filozofuar. Për të bërë një përgjithësim bashkëkohor ai merr shkas nga një legjendë, nga një proverb apo nga një këngë nga një gojëdhënë popullore. Me këtë poeti tregon vazhdimësinë e kulturës shqiptare, tregon ekzistencën e qëndresën e popullit.

Fatmir Terziu

Ali Podrimja mbështetet në shumë figura, metafora dhe simbole të poezisë popullore të Republikës së Shqipërisë së Veriut për të mburjuar dhe ndërtuar lirikën e tij të trazuar me vizionin stoik të malësorëve. Megjithatë është një fllad i lehtë romantik që përshkon poezinë e tij, sikundër e pati cilësuar dikur kritiku Rexhep Qosja, ky përdorim krijues i folklorit është i shkrirë fuqishëm me një rrjedhë realiste, herë herë ironike, që buron pjesërisht nga etika e revoltës në traditën e Migjenit (1911 – 1938) dhe Esad Mekulit (i lindur më 1916).⁴⁹

Ibrahim Rugova

Në atmosferën e plotë të rrëfimit të Podrimjes ndeshemi me të këqijat e botës moderne: me vetminë, me humbjen, me harrimin e qeniesisë njerëzore, të cilat në mesazhin e tij shtojnë

⁴⁸ Ardian – Christian Kycyku, U dynd dynjaja dhe gëlltitur mbet nga vargjet (Disa fjalë mbi praninë e Ali Podrimjes në poezinë evropiane), marr nga internet në uebfaqen revistahaemus.blogspot.com

⁴⁹ Fatmir Terziu, Kritika ndryshe: Vëzhgim në brendësi të prozës e poezisë shqiptare II, USA, 2010

kërkesën: të bëhemi të qëndrueshëm ndaj tyre dhe me vetëdijen tonë të krijojmë kuptime dhe genie të reja... nëpër tekstin e poezisë së Podrimjes, rrëfimi i tij nuk mbyllet.

Filippo Bettini

Kodi i poetikës së Podrimjës bazohet te gurshmëria... Ashpërsia e shkëmbit që i jep, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në metaforë, forcën dhe qëndresën e identitetit... Rimarrja e mitit, bota e ndjenjave të thella dhe vetjake, përballja e përditshme me punën e vështirë të shkrimit dhe me mjeshttrin e vështirë të poetit hyjnë në alegorinë e një gjendje historiko-kohore. Podrimja paraqitet në të njëjtën kohë si poet i shquar i Kosovës dhe një zë i fuqishëm dhe origjinal i poezisë evropiane.

Bashkim Kuçuku

Ali Podrimja ka krijuar shëmbëlltyrën poetike të etnisë. Prandaj poezia e tij simbolike dhe eliptike në shprehje, është vizionare në mendim, paraprijëse, tepër ndikuese dhe e popullarizuar. Dihet se poetët që krijojnë ose rikrijojnë shëmbëlltyrën e shenjtëruar të kombit, fitojnë meritueshëm dafinën e poetit kombëtar.

Mensur Raifi

Pavdekshmëria nuk është iluzion i ikjes nga defetizmi për t'u futur në legjendë, por qëndrim burrëror ndaj vdekjes që inicion një mësim për jetën.

Marin Soresku

Kam lexuar Ali Podrimjen, poet i shkëlqyer.

Janice Mathie Heck

Poezitë flasin mbi humbjen, por mbase, ç'është më me rëndësi, MUNGESËN e gjërave. Ka një skenë mangësie absolute, braktisjeje emocionale, të dëbimit dhe të vetmisë së plotë tmerruese... Podrimja është poet mjeshtëror, ndonëse trishtueshëm absurdues... është mallkim të jesh poet, e adhuroj shumë poezinë e tij.

Leszek Szaruga

Nuk ka se si të mos shqetësohet lexuesi kur lexon poezinë e Ali Podrimjes, që vërtet të pushton e të tronditë: Nën qiellin e zymtë/ Një nënë i jep gji / Fëmijës së vdekur / dhe nga syri im i shqyer / rigon rigon rigon / Oh Zot... A nuk është kjo poezi dokument dhe dëshmi e hidhur e tragjedisë së ndodhur në fund të shekullit XX?

Ardian – Christian Kocyku

Ali Podrimja, poet i gjuhës shqipe, lindur më 28 gusht 1942 në qytetin Gjakovë të Kosovës, autor i një vepre poetike befasuese, i cilësuar si njëri nga themelvënësit e poezisë shqiptare moderne.⁵⁰

Sabri Hamiti

Ali Podrimja fillimisht poet me ndjenjë të rebeluar. Poezia e tij ndërtohet mbi dilema njerëzore, dhembje e kërkime të përhershme, me gjuhë krejt të figuruar e formë eliptike, për të shpërthyer në fund prapë me ndjenjën personale të fortë dhe elegjiake te Lum Lumi.

Eva Lipska

Ali Podrimja është poet i një rangu evropian.

Robert Elsie

Ali Podrimja është poet i kursyer. Vargu i tij është kompakt në strukturë, kurse figuracioni i tij është i drejtpërdrejtë, i saktë dhe pa fjalomani artificiale. Çdo fjalë ka funksion.⁵¹

Basri Çapriqi

Ali Podrimja bën një shmangie të madhe stilistike dhe me shmangien e vet bën që të krijohet një shmangie e madhe në poezinë shqipe në përgjithësi. Është ndoshta kryesori që i ka dhënë guxim këtij tipi të gjuhës, që i ka dhënë një fuqi jo të zakonshme identifikuese dhe receptuese në një mjedis jo shumë të përgatitur për të komunikuar me një strukturë të tillë gjuhe.

⁵⁰ Ardian – Christian Kocyku, U dynd dynjaja dhe gëlltitur mbet nga vargjet (Disa fjalë mbi praninë e Ali Podrimjes në poezinë evropiane), marrë nga internet në uebfaqen revistahaemus.blogspot.com

⁵¹ Histori e Letërsisë Shqiptare, përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu. Tiranë & Pejë: Dukagjini 1997, fq. 312.

Sadik Bejko

Një poet që ka arritur lartësi të tilla mund ta shtrojë pyetjen: Përse shkruaj? Si duket kjo është pyetja torturuese për çdo poet të vërtetë. Në rastin e Aliut kësaj nuk mund t'i shpëtosh.

Krzysztof Czyzewski

Cikli i poezive Lum Lumi që është një cikël i veçantë në librin "FLAKA E VJEDHUR" të Podrimjes, është një cikël kushtuar birit të tij që vdiq para kohe. Kjo poezi tronditëse dhe rrëqethëse lexohet si një tragjikë e thellë e përjetuar e një liriku ekzistencial, që dëshmon fillimin e një epoke të re në zhvillimin e formës dhe gjuhës poetike jo vetëm në historinë e letërsisë shqipe...

Visar Zhiti

Duke qenë sintetik, por edhe i asosacioneve tronditëse, vargu i Podrimjes na lejon komentet e kapërcimeve pindarike, ndërkohë Poeti Ynë është më shumë homerik dhe konkretisht ngjan dhe me orteqet e Homerit të fundit në Ballkan, me Gjergj Fishtën, gjithsesi në të kundërtën e tij, se poemat e Podrimjes janë tejet të shkurtra, dramatikisht me pak vargje, ku satirën therëse bardi i ri e ka shndërruar në ironi të idhët, similitudat në metafora.

Ewa Smietanska

Ali Podrimja gjithnjë synon të kapë qenësinë e fenomeneve dhe të gjërave, depërton në substancën shpirtërore të ngjarjeve dramatike, duke hyrë në brendinë e çështjes...

Agim Vinca

Poezia e Ali Podrimjes është poezi ankthi e tmerri; «poésie forte». E shkruar në kohë dhune, ajo i bën apologji jetës edhe atëherë kur këndon për vdekjen...

Gani Bobi

Për ndryshim nga të gjithë ata poetë, të cilët i kanë kënduar Kosovës, Hija e tokës është vepra poetike më e plotë, më e përjetuar dhe më avangardja, qoftë për strukturën e poetikës së vet, qoftë për guximin e fjalës që është thënë deri më sot për këtë truall.

Merita Bajraktari – Januzi, studiuese e letërsisë

Ali Podrimja është autor i më shumë se dhjetë vëllimeve me poezi dhe konsiderohet si përfaqësuesi më tipik i poezisë së sotme shqiptare. Botën e vet poetike poeti e artikulon përmes një sistemi figurativ të konsoliduar (veçanërisht me simbolin dhe metaforën) dhe me një shkallë mjaft të lartë ndjeshmërie. Duke qenë poet bashkëkohor, Ali Podrimja e çliron poezinë shqipe nga kornizat konvencionale, duke i dhënë shprehje të lirë vargut, shprehje metaforike, shprehje ironike që vënë në pah idetë dhe mesazhet e tij artistike.

Petrit Palushi

Lum Lumi është një metaforë mbi vetë ekzistencën dhe rreth një pyetjeje: Ç’kuptim ka jeta kur vdekja pikon ngeshëm çdo ditë mbi të? Nëse te Andrra e jetës Ndre Mjedja trandet vetvetiu mbi personazhin e krijuar dhe ajo ka të bëjë me trandje brenda përfytyrimit, te Podrimja trandja është shumë më tragjike dhe rrëfimi te Lum Lumi merr trajtën e një prometeizmi poetik.

Dhurata Hamzai

Duke qëndruar një çast për të lexuar disa poezi të Ali Podrimjes, të cilat tashmë gjenden në botime të reja dhe të hershme të vëllimeve të tij poetike, befas vë re një dukuri tjetër nga ato që janë thënë me të drejtë prej zërit të kritikës. Përveçse lëndë poetike, poezia e Podrimjes ka regëtimën e rrëqethjen gati inkoshiente të një shqisë si të përtejme, sidoqoftë është shqisë që prek, lëndon dhe dhemb.⁵²

Wolfgang Petrisch

Dhjetë vjet pas krijimit të këtyre poezive ndërmjet Prishtinës, Munihut e Salsburgut, prezantohen prapë këto vlera (Wiser Verlag): lirikë e angazhuar, e gjithanshme dhe aktuale...

Marius Qelaru

Poezia e tij elegante, nganjëherë me tentë eliptike, duket se përshkruan një tablo të magnetizuar (por jo të zymtë), e përmbushur me tema madhore, dilematike për njeriun...

⁵² Dhurata Hamzai, Poezia e Podrimjes, Shqisa dëshmitare, Revista Shkencore Haemus, Tiranë, 2004.

Sylvia Treudel

Ata që ndjejnë pak dashuri ndaj poezisë në fakt nuk mund të mos e lexojnë këtë vëllim të Ali Podrimjes. Temat janë të fuqishme: vdekja, identiteti i rrezikuar, humbja...

Mazllum Saneja

Në poezinë moderne shqipe solli një ndjeshmëri dhe intonacion të ri poetik. Në veprat e tij shtron probleme universale të ekzistencës njerëzore të rëndësishme në luftën e individit përballë sistemeve totalitare.

Visar Zhiti

Dikur kam shkruar se Ali Podrimja, ashtu si Naim Frashëri, poeti kombëtar i shqiptarëve.

Sali Bashota

Vepra poetike Lum Lumi e Ali Podrimjes është njëra ndër veprat më të mira të poezisë shqipe të shekullit XX. Ka diçka magjike dhe profetike që e tërheq forcën e krijimit të saj, madje një Trini e Shenjtë: midis Dhembjes, Ëndërrimit, Kujtimit...

Arian Leka

Podrimja mbërriti si dhuratë, dhanti, që prej poezisë së ‘gjakut të pa falur’. Këtu ai nis të shtjellë një botë mitike vetjake. Podrimja vjen i shoqëruar përherë me ndjenjën dhe me ca dama të zeza që nuk i ndahen herë atij vetë e herë kombit të tij.

Xhevahir Spahiu

I duhet botës ky zë lirie nën qiell robërie, ky zë i ankthit, dramatik të njeriut modern. I duhet njerëzimit kjo këngë tronditëse e të vërtetave të mëdha, këngë thellësisht njerëzore e njeriut të paepur në betejat e pasosura të jetës. Është me fat, është i pavdekur një popull që lind poet si Ali Podrimja.

Hans-Joachim Lanksch

Më bani përshtypje ngjeshunia e teksteve të Aliut – s’ka fjalë të tepërta, s’ka as rrokje të tepërta. Poezia e tij nuk tregon ndonji ngjarje dhe as nuk shpalos drejtpërsëdrejti ndonji mendim

a ideologji, ajo nuk asht përshkruese, por asht shumë domethanëse me shumë pak fjalë. Me një fjalë: më bante përshtypje vlera estetike e poezisë së tij.⁵³

⁵³ Marrë nga <https://albertvataj.blogspot.com/2012/07/perkthyesi-hans-joachim-lanksch-thjesht.html>, Përkthyesi Hans Joachim Lankch – Thjesht u dashurova me poezinë e Ali Podrimjes.

Përfundim

Letërsia shqipe në shek. XX shënon arritje të mëdha si në aspektin tematik ashtu edhe në atë formal. Në gjysmën e dytë të shek. XX, zhvillimi i letërsisë shqipe merr dimensione të reja të zhvillimit. Në këtë periudhë, për shkak të kushteve historike, letërsia shqipe krijon katër qendra (Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni, Shqipëri) të zhvillimit të saj. Në çdo qendër të botës së letrave shqip kemi shfaqje të unikaliteteve, por në të njëjtën kohë të gjitha së bashku krijojnë botën e plotë të letërsisë shqipe. Vepra e Ali Podrimjes shënon një moment të rëndësishëm të zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë. Për shkak të kushteve historike dhe shoqërore në të cilat mori jetë vepra e tij, Podrimja krijoi një sistem të veçantë komunikimi duke arritur në një përsosmëri formale. Në kushtet e censurimit, vepra e tij shfaqet si kërkim i formës gjuhësore më të sigurt për të mbajtur të gjallë komunikimin me unin kolektiv. Po në këto kushte, ajo do të bëhet pjesë e jetës shpirtërore të shqiptarëve në Kosovë, por jo vetëm.

Ali Podrimja poeti i Kosovës i cili në fillim të viteve dyzet të shekullit të kaluar, zhvillon një betejë dramatike të pasosur: janë fati dhe fatkeqësitë kolektive me të cilat do të përballet gjatë tërë jetës poeti i shquar shqiptar. Që herët do të mbetet jetim, pa nënën dhe pa babanë. Por jetim do të mbetet edhe karshi Kosovës së vet të lindjes, e cila ashtu siç e pa dhe e gjeti si fëmijë dhe të atillë e përcolli deri në fund të shekullit, do të jetë nën terror të pandërprerë, nën masakrat e pushtuesit të huaj. Dhe në këtë kontekst të fatit të vet dhe atij kosovar, poetin do ta godasë edhe fatkeqësia e quajtur Lumi-biri, të cilin ia rrëmbeu vdekja në moshën e re. Përballë këtij mozaiku të fatit kosovar dhe podrimjan, poeti Ali Podrimja do të zhvillojë një luftë stoike, me vullnet të ndezur, duke i përballuar të gjitha goditjet e fatit individual dhe kolektiv. E tërë poezia e tij, në fakt, bart në vete shqetësimin, dramën, tragjizmin e këtij fati, duke u artikuluar si art majash në letërsinë bashkëkohore shqiptare, si art poetik që çan rrugë dhe pranohet si vlerë universale. Andaj, si përfundim mund të themi se poezia e Ali Podrimjes është një ngjarje e veçantë në letërsinë bashkëkohëse shqipe, sepse është ngjarje e hidhur e dinamizmit të gjithanshëm të psiqikës njerëzore.

Marrëdhënia simbiotike mes gjuhës dhe letërsisë ka bërë që letërsia të jetë objekt studimi për gjuhëtarët dhe gjuha për studiuesit e letërsisë. Shfaqja unike e gjuhës në komunikimin letrar, si një lloj i veçantë, është burim i zhvillimit të gjuhës në periudha të ndryshme. Në sistemet

letrare zënë fill njësitë e reja leksiko – semantike të një gjuhe, ku në fillim shfaqen si përdorime të figurshme dhe më pas bëhen pjesë e natyrshme të vetëdijes gjuhësore të folësve të asaj gjuhe. Në historinë e zhvillimit të letërsisë së një kombi periudhat më të ndritura të saj, janë njëkohësisht edhe momente më të rëndësishme të zhvillimit të gjuhës. Larmia e madhe e stileve në poezinë shqipe të gjysmës së dytë të shek. XX, sidomos pas viteve '60, të mundëson përthyerjen në dritën e shumë aspekteve teorish e metodash të ndryshme, për shkak të larushisë që mbart kjo poezi në sferën strukturore, por edhe ideore. Larmia e formave shkrimore, kryesisht llojshmëria e formave poetike në ditët e sotme lind domosdoshmërinë e analizave si formale dhe konceptuale mbi gjuhën e llojeve të ndryshme të poezisë. Letërsia si arti i fjalës gdhend formën e vargëzuar ose jo, me fjalën e lëvizjet kuptimore të saj. Të punosh eksperimentalisht mbi gjuhën dhe mbi kulturën që ajo vë në qarkullim, do të thotë pra të punosh në dy fronte: në frontin e shënjestës me fjalët (dhe kur shkatërron dhe riorganizon fjalët riorganizon mendimet) dhe duke luajtur mendimet, duke e çuar kështu fjalën të prekë horizonte të reja e të pamenduara.

Poetika e Podrimjes është në kërkim të vazhdueshëm të mundësive të reja dhe origjinale të shprehjes së emocionit, të imagjinatës dhe të filozofisë së jetës që vijnë dhe shfaqen përmes një simbolike të dendur në një cikël poezish: *Guri*, *Kulla*, *Cungu*, *Poema e heshtjes*, *Kali i Trojës*, *Dëftore* dhe *Pylli*. Titujt e cikleve poetike të mësipërme janë kryekëput simbolike. Simbolika e tyre na orienton drejt kulturës dhe historisë shqiptare. Simbolika e tyre është domethënie e pasurimit strukturor të këtyre leksemave, e një aktualizimi semantik të mbishtresëzimeve të tyre që nga kohët antike deri në kohët moderne.

- Guri është shprehje e qëndresës që në kohët e lashta, është shprehje e autoktonisë në vendin e tij.
- Kulla është simboli i qëndresës përballë invazionit të vazhdueshëm, është simbolika e shpirtit të shqiptarit në viset e Kosovës, është djepi i lirisë dhe intimiteti të tij personal.
- Cungu, simbol i cungimit të individit në një regjim diktatorial, shovinist, por edhe i mostjetërsimit edhe pse i cunguar.
- Heshtja, simboli i censurimit dhe të një mënyre të mbijetesës. Marrëdhënia përcaktuese mes fjalës heshtje dhe fjalës poemë, bën që leksema “heshtje” të ketë një mbishtresëzim kuptimor tjetër antonimik, ku heshtja është një poemë, një rebelim i

poetit. Heshtja është syri i fjetur me fyell në gojë, të cilit i cicërojnë zogjtë, ndaj ajo është më e vjetër se guri dhe më e fortë se vdekja.

Pas gjithë punës studimore kemi nxjerrë disa analiza dhe përfundime lidhur me veprën poetike të Ali Podrimjes:

- Poezia e Podrimjes krijon një raport të veçantë me lexuesin, ajo herë e grish në pafundësi komunikimin, herë kërkon mund për të arritur në fshehtësitë e lëndës poetike.
- Krijimtaria poetike e Podrimjes është e larmishme dhe shumë e pasur si në aspektin e volumit po ashtu edhe në aspektin cilësor, duke shënuar majat e pasurisë poetike në botën e letrave shqipe, por edhe evropiane. Vepra e Podrimjes është dhe ka qenë objekt studimi i kritikës shqiptare dhe botërore.
- Përsosja e gjuhës poetike të Podrimjes fillon që në botimet e para deri në krijimet e fundit. Kalimi nga një periudhë krijimi në një periudhë tjetër karakterizohet me tipare të veçanta të gjuhës poetike. Duke filluar nga një gjuhë deklarative në fillim të krijimtarisë duke përfunduar në një gjuhë sintetike, eliptike, simbolike dhe me një shtresëzim figurative shumë të madh.
- Gjuha poetike e Podrimjes është e stërholluar, e rafinuar, e kursyer dhe konkrete, jashtëzakonisht karakteristike, e mprehtë dhe e ashpër.
- Krijimtaria poetike e Podrimjes është e larmishme dhe shumë e pasur si në aspektin e volumit po ashtu edhe në aspektin cilësor, duke shënuar majat e pasurisë poetike në botën e letrave shqipe, por edhe evropiane. Vepra e Podrimjes është dhe ka qenë objekt studimi i kritikës shqiptare dhe botërore.
- Poetika e Podrimjes është strukturuar duke u mbështetur mbi metaforën, simbolin, por në fazën e tretë të krijimtarisë së tij kemi poetikë më të prerë, më të drejtpërdrejtë me një shkallëzim të ironisë deri në sarkazëm.
- Në poezinë e Podrimjes krahasimi nuk mbetet vetëm në rrafshin e njohjes së tematikës së poezisë, apo ciklit poetik, por kërkon një fushë të gjerë të njohjes mbi

kulturën, historinë, aktualitetin, letërsinë dhe botën shpirtërore të besimit, që nga kohët mitike deri në ditët modern.

- Ndër kolosët më të mëdhenj të letërsisë shqipe, jashtë trungut të Shqipërisë mëmë, mund të përmendim poetin Ali Podrimjen.
- Letërsia shqipe në Kosovë, në gjysmën e dytë e shek. XX, nuk censurohet formalisht, por vetëm tematikisht.
- Në ligjërimin poetik të Podrimjes vihet re një kompleksitet i shprehjeve poetike.
- Në poezinë e Podrimjes krahasimi nuk mbetet vetëm në rrafshin e njohjes së tematikës së poezisë, apo ciklit poetik, por kërkon një fushë të gjerë të njohjes mbi kulturën, historinë, aktualitetin, letërsinë dhe botën shpirtërore të besimit, që nga kohët mitike deri në ditët moderne.
- Lexuesi në poezinë e Podrimjes gjen tema dhe motive tematike të botës shqiptare parë në dimensionin kohor dhe hapësinor, por nga ana tjetër gjen edhe tema dhe motive universale.

Literatura

- 1) Aliu Ali, Leximi i poezisë. (persiatje mbi poezinë e Ali Podrimjes), në “Don Kishoti te Shqiptarët”, Shkup 1995.
- 2) Berisha Anton, Ligjërimi poetik si vetëdije artistike: Lum Lumi, në “Teksti Poetik”, Prishtinë, 1985, faqe 82-87
- 3) Çiraku Ymer, Ali Podrimja – Poet i prirjeve refleksive, në “Gjurmime në Letërsinë Shqiptare” Tiranë, 2002.
- 4) Feraj Hysamedin, E pafilozofuara, Zenit Editions, Tiranë, 2011.
- 5) Hamiti Sabri, Krijimi e revolti, në “Variante”, Prishtinë, 1974.
- 6) Kadriu Zeqir, Bota poetike e Abdylazis Islamit, Luma, Tetovë, 1998, faqe 3 – 28.
- 7) Kadriu Zeqir, Mozaik gjuhësor e letrat, “Albas” Tiranë, 2014.
- 8) Podrimja Ali, Buzëqeshje ne kafaz, Dukagjini, Pejë 1994.
- 9) Podrimja Ali, Credo, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- 10) Podrimja Ali, Gjumi i tokës, Poezi e zgjedhur, ASHAK, Prishtinë 2006.
- 11) Podrimja Ali, Kush do ta vrasë ujkun. Poezi të zgjedhura nga A.Aliu, Alb - Ass, Tetovë – Tiranë 2002.
- 12) Podrimja Ali, Litari I Ankthit, Përgatitur nga B. Kuçuku, Toena, Tiranë 2002.
- 13) Podrimja Ali, Lum Lumi, Rilindja, Prishtinë 1982.
- 14) Podrimja Ali, Pikë e zezë në blu, Onufri, Tiranë 2005.
- 15) Podrimja Ali, Poezi a c. di Xh. Spahiu e D. Agolli, Naim Frashëri, Tiranë 1986.
- 16) Podrimja Ali, Sampo II, Valët, Prishtinë 1980.
- 17) Podrimja Ali, Shamijat e përshëndetjeve, Rilindja, Prishtinë, 1963.

- 18) Podrimja Ali, Torzo, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- 19) Qosja Rexhep, Valle e simboleve: Sampo, në “Panteoni i Rralluar”, Prishtinë 1973.
- 20) Rugova Ibrahim, Ironia poetike, në “Kritika” ASHAK, Prishtinë 2007.
- 21) Ukaj Ndue, Perceptime poetike të Ali Podrimes, Mendime mbi librin “Pikë e zezë në blu”, botuar nga Onufri, Tiranë, 2006.